




REPUBLIKA E KOSOVËS

MINISTRIA E INDUSTRIË,
NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË

STUDIMI I ZINGJIRIT TË VLERËS PËR SEKTORËT E TEKSTILIT, VESHJES DHE LËKURËS

Prishtinë, 2021



FINANCUAR NGA:



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E INDUSTRIË,
NDERMARRËSISË DHE TREGTISË

**MINISTRIA E INDUSTRIË,
NDERMARRËSISË DHE TREGTISË**

Lagjja e Spitalit, rr."Arbënor e Astrit
Dehari", nr. 21 10000 - Prishtinë/ Republika
e Kosovës.

E-mail: zkp.mti@rks-gov.net

Tel: + 383 (0) 200 36 512

+383 (0) 200 36 543

KOMENT: Ky studim është financuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, pikëpamjet e shprehura në këtë raport i përkasin autorëve të D&D dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Raporti është hartuar duke u bazuar në të dhënat nga sondazhi me ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në sektorin e tekstilit, veshjes dhe lëkurës, dhe funksioneve të tyre në zingjirin e vlerës. Mostra e marrë paraqet një pasqyrë të përafërt të dinamikës të tendencave të tregut dhe zingjirit të vlerës, por që nuk pretendon që tërësinë e këtij sektori ta përfaqësoj në përpikmëri.

Lista e shkurtesave

AAP	Arsim dhe Aftësim Profesional
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
CEFTA	Marrëveshja për Tregti të Lirë në Evropën Qëndrore
DK	Dogana e Kosovës
EFTA	Marrëveshja për Tregti të Lirë në Zvicërr, Norvegji, Islandë dhe Lihtenshtajn
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
KIESA	Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
MF	Ministria e Financave
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
MPHI	Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
NVM	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
OAK	Oda e Afarizmit të Kosovës
OEK	Oda Ekonomike e Kosovës
PE	Polietileni
PP	Polipropileni
SHKMV	Shoqata Kosovare për Marketing të Veshmbathjeve
UNIDO	United Nations Industrial Development Organization
WIEGO	Women in Informal Employment: Globalizing and Organizing

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
METODOLOGJIA	6
Korniza e mostrës.....	7
1. ANALIZA E SEKTORËVE NË NIVEL GLOBAL	8
2. PASQYRË E SEKTORËVE TË TEKSTILIT, VESHJES DHE LËKURËS NË NIVEL VENDOR	14
2.1 Prodhimi i Tekstilit	14
2.2. Prodhimi i Veshjes	17
2.3. Prodhimi i Lëkurës dhe Produkteve prej Lëkurës.....	19
3. ANALIZA E ZINGJIRIT TË VLERËS	23
Harta e Zingjirit të Vlerës.....	24
Furnizimi (perspektiva e prodhuesit)	25
Furnizimi (perspektiva e furnizuesve)	26
Analiza e Zingjirit të Vlerës – Prodhuesit.....	29
Tregjet vendore dhe ato eksportuese – Perspektiva e prodhuesve	31
Pengesat në prodhim dhe eksport	33
Qarkullimi i industrisë së prodhimit të Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës	34
Inovacioni	34
Transporti	36
Ambienti biznesor	41
Rrjetëzimi (Perspektiva e ndërmarrjeve).....	42
Mbështetja e sektorëve të Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës nga akterët relevant.....	44
RASTE STUDIMI – NDËRMARRJA A DHE NDËRMARRJA B	45
KUFIZIMET KRYESORE TË SEKTORËVE	47
REKOMANDIMET	49

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Produktet e prodhuara në kuadër të sektorëve të Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës, në kontekstin mikro janë produkte esenciale dhe të nevojshme në jetën e përditshme, kurse në kontekstin makro, paraqesin rëndësi të veçantë në zhvillimin ekonomik dhe social, sidomos në vendet në zhvillim. Produktet e prodhuara në kuadër të sektorëve të Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës janë një pikë hyrëse në zinxhirët global të furnizimit dhe tregjet e eksportit.

Industria e Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës punon në tre parime kryesore, përkatësisht në dizajnimin, prodhimin dhe shpërndarjen e materialeve të ndryshme. Një gamë e gjerë procesesh përdoren për të prodhuar linja të shumëllojshme të produkteve të gatshme dhe gjysmë të gatshme. Megjithatë, në vitet e fundit është theksuar dukshëm presioni rreth ndikimit nga prodhimi dhe hedhja e këtyre produkteve në mjedis. Rritja e preferencës së konsumatorit ndaj produkteve të qëndrueshme po detyron ndërmarrjet e Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës të përqendrohen në ristrukturimin e biznesit të tyre dhe investimin në praktikën prodhuese që synojnë produkte të qëndrueshme dhe praktika me ndikim pozitiv në mjedis.

Për të mundësuar zhvillimin e mëtutjeshëm dhe për të siguruar që sektorët të mbeten konkurrues, ekziston një interes në rritje për të kuptuar më mirë këta sektor dhe zinxhirët e lidhur me vlerat. Rrjedhimisht, D&D e mbështetur nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), kreu studimin e Zinxhirit të Vlerës për të kuptuar më mirë strukturën e sektorëve të Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës, identifikimin e pengesave kyçe, trendet aktuale, si dhe orientimin e 3 sektorëve në përgjithësi. Të gjeturat nga ky studim janë të bazuara në (81) intervistat e realizuara me NVM, të cilat përbëjnë një mostër gjithëpërfshirëse të kësaj industrie dhe (9) intervistave të realizuara me akterët relevant të cilët mbështesin këtë industri.

Në vendin tonë në sektorët e Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës, aktualisht operojnë afro 540 ndërmarrje, të cilat kanë të punësuar 2,373 punëtorë formal, numër ky i cili shënon rritje krahasuar me dy vitet e kaluara. Meqë në vitin 2018 kishim 390 ndërmarrje aktive me 2,104 punëtorë, ndërsa në vitin 2019 kishim 350 ndërmarrje aktive me 1,864 punëtorë në 3 sektorët.

Të njëjtat ndërmarrje arrijnë qarkullimin vjetor mbi 31.84 milion euro, përkundër situatës pandemike në të cilën gjendemi. Rajonet në të cilat këto ndërmarrje janë më shumë të përqendruara janë Prishtina, Ferizaji, Prizreni dhe Gjakova. Ndërsa produktet e tyre kryesisht eksportohen në vendet e BE-së dhe CEFTA-së.

Krahas kapacitetit të këtyre sektorëve për zhvillim të mëtejshëm, siç është theksuar dhe më lartë përmes këtij studimi janë identifikuar dhe sfidat apo kufizimet e sektorëve për të operuar tutje me aktivitetet e tyre. Ndër to janë: Aftësimi profesional i të punësuarve në prodhim, Pengesat në proceset e eksportit, Mungesa e furnizimit me lëndë të parë në Kosovë (pa pas nevojë për import), Mungesa e zonave industriale në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, si dhe Pandemia e shkaktuar nga Covid-19.

HYRJE

Sektorët e Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës paraqesin rëndësi të veçantë në aspektin socio-ekonomik në të gjithë globin, ndonëse është ngritur shqetësimi rreth ndikimit të këtyre sektorëve në mjedis për shkak të trendeve të shpejta të modës dhe presionit shoqëror rreth dukjes.

Në të gjithë botën, industria e tekstilit dhe veshmbathjes gjeneron rreth 20 milion vende pune në sektorin formal dhe të paktën tre herë më shumë në sektorin jo-formal, numri më i madh prej tyre në vendet në zhvillim, UNIDO¹ WIEGO² Castaneda-Navarrete et al.³. Qarkullimi vjetor në nivel Global arrin 1.46 trilion dollar Amerikan, kurse në Evropë industritë e Tekstilit dhe Veshmbathjes dhe Lëkurës, janë pjesë e rëndësishme e ekonomisë dhe trashëgimisë kulturore. Në kuadër të këtyre sektorëve janë të regjistruar rreth 200,000 ndërmarrje duke gjeneruar mbi 200 miliardë euro qarkullim vjetor dhe duke punësuar gati 2 milionë njerëz, të dhëna për vitin 2019⁴. Ato përfaqësojnë një zinxhir vlerash shumë të gjerë, duke e bërë BE -në lider botëror në kreativitet dhe një pionier në inovacionin industrial.

Evropa është ndër tregjet kryesore të eksportuesve të veshjeve dhe tekstilit, ku 21.3% e vlerës globale të importit të veshjeve (2019) importohet nga BE, prej të cilave, 71.7% të vlerës e përbëjnë gjashtë shtete, gjegjësisht, Gjermania, Franca, Britania e Madhe, Spanja, Holanda dhe Italia.

Megjithatë presioni shoqëror është gjithnjë në rritje në lidhje me mjedisin, dhe kjo paraqet një sfidë evidente për sektorin e Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës, duke konsideruar rritjen në trendet siç janë “Moda e shpejtë”, ku kërkesa për siguri i vazhdueshëm të stileve të reja me çmime shumë të ulëta, ka çuar në rritje të madhe të sasisë së rrobave të prodhuara dhe hedhura. Për të trajtuar ndikimin në mjedis në Mars të 2020-es, Komisioni Evropian miratoi planin e ri të veprimi i cili përfshin strategjinë e BE-së për tekstilet, që synon stimulimin e inovacionit dhe nxitjen e ripërdorimit brenda sektorëve. Nga ana tjetër, zhvillimet industriale dhe ndikimi i teknologjisë do të vazhdojë të ndikojë dramatikisht edhe në industrinë e prodhimit të tekstilit dhe lëkurës, qoftë në aspektin e automatizimit së makinerisë, digitalizimit, inteligjencës artificiale apo forma tjera të avancuara teknologjike.

Ky raport i Zingjirit të Vlerës paraqet një rëndësi të veçantë në lidhje me sektorët e Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës, pasi që është i pari për këta sektorë dhe ka për qëllim mbështetjen e konkurrencës së sektorëve. Përmes këtij raporti do të identifikohen lidhjet që mungojnë, boshllëqet dhe kufizimet e Zingjirit të Vlerës. Gjithashtu, të gjeturat do mund të shfrytëzohen për hartimin e strategjive të reja dhe politikave të ardhshme për këta sektorë.

¹ United Nations Industrial Development Organization (2020). *Monthly Index of Industrial Production at the 2-digit level of ISIC*.

² Women in Informal Employment: Globalizing and Organizing (2020). *Home-based workers face a new kind of isolation*.

³ Castaneda-Navarrete J., et al. 2020, *Covid-19's impact on global value chains, as seen in the apparel industry*.

⁴ EFC, COTAGE, EURATEX, INDUSTRYALL-EUROPEAN TRADE UNION, Joint statement, Brussels, May 2021.

METODOLOGJIA

Ky hulumtim është realizuar nga kompania konsulente D&D Business Support Center dhe është financuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, i njëjti është zhvilluar duke u bazuar në burimet primare dhe ato sekondare.

Zingjiri i Vlerës për sektorët e Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës është hartuar me qëllim që Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përkatësisht Departamenti i Industrisë, identifikoj produktet konkurruese ose grup të produkteve të sektorëve të Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës dhe të përcaktojnë masat adekuate të mbështetjes për rritjen, zhvillimin e mëtejshëm dhe identifikimin e mundësive tërheqëse për të përmirësuar dhe azhurnuar zingjirët ekzistues të vlerës.

Ky raport gjithashtu ka për qëllim stimulimin e rritjes së sektorëve përkatës, krijimin e vendeve të reja të punës, rritjen e të ardhurave dhe nxitjen e rritjes ekonomike në përgjithësi.

Me qëllim të arritjes së këtij objekti, për studimin dhe hartimin e Zingjirit të Vlerës, është realizuar hulumtimi nëpërmjet pyetësorëve të ndarë si në vijim:

1. Pyetësori për akterët e sektorëve të Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës,
2. Pyetësori për ndërmarrjet prodhuese,
3. Pyetësori për ndërmarrjet furnizuese,
4. Pyetësori për ndërmarrjet transportuese.

Fillimisht janë identifikuar akterët relevant të sektorëve, dhe më pas është bërë identifikimi i ndërmarrjeve prodhuese, furnizuese dhe transportuese për intervistim.

Mbledhja e të dhënave për këtë hulumtim është bërë përmes vizitave në ndërmarrjet e intervistuar, apo takimeve B2B me pronarët e ndërmarrjeve apo ndonjërin nga drejtuesit e lartë të cilët kanë pas përvojë të mjaftueshme në aktivitetet e përgjithshme të biznesit.

Paralelisht, në takimet e realizuara dy (2) ndërmarrje prodhuese janë konsideruar si raste studimi të cilat tregojnë mbarëvajtjen e aktivitetit të punës që nga themelimi i ndërmarrjes deri më tani.

Përveç hulumtimit të realizuar përmes pyetësorëve, janë mbledhur të dhënat e nevojshme dhe nga institucionet relevante si Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe Agjencioni i Statistikave të Kosovës, informacione këto të cilat janë përdorur si plotësim dhe analizë dytësore e Zingjirit të Vlerës për sektorët e Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës.

Korniza e mostrës

Për të pasqyruar sa më saktë gjendjen e sektorëve të Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës, D&D Business Support Center ka pranuar listën e ndërmarrjeve prodhuese të sektorëve të lartë përmendur nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Në listën e dhënë kanë qenë të përfshira 808 ndërmarrje të cilat veprojnë në prodhimin e Veshjes dhe Tekstilit, dhe 17 ndërmarrje të cilat veprojnë në prodhimin e produkteve nga Lëkura.

Njëkohësisht nga D&D Business Support Center janë identifikuar 11 ndërmarrje furnizuese dhe 5 ndërmarrje transportuese në 3 sektorët e targetuar në mënyrë që të kuptohet procesi i punës që nga hallka e parë e zingjirit që ka të bëjë me furnizimin me lëndë të parë apo materiale deri tek transporti i produktit final të prodhuar.

Përzgjedhja e mostrës është bërë duke ju përshtatur ndarjeve të paracaktuara në kontekstin rajonal dhe komunal, duke tentuar që të përfshijë gjithë Republikën e Kosovës. Gjithashtu, në rrafshin gjinor, dhe llojit të veprimtarisë në mënyrë që kjo mostër të jetë sa më gjithëpërfshirëse, dhe të paraqes qartë veprimtarinë dhe procesin e ofrimit të shërbimit nga ndërmarrja. Vlen të theksohet se nga 81 ndërmarrje të intervistuar gjithsej, 41 prej tyre janë të udhëhequra nga gjinia femërore, kurse 40 nga to drejtohen nga gjinia mashkullore. Pjesa dërmuese e ndërmarrjeve të udhëhequra nga gjinia femërore janë ndërmarrje prodhuese.

Theks të veçantë si pjesë e këtij studimi i është dhënë dhe intervistave me 9 akterët relevant të këtyre sektorëve, duke veçuar bashkëpunimin e vazhdueshëm me Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe kontributin e shoqatës KAMA në ndarjen e informacioneve të nevojshme për të pasuruar këtë studim.

Bazuar në të gjeturat e këtij studimi dhe informacionet e pranuar nga akterët dhe institucionet relevante është hartuar Zingjiri i Vlerës për Sektorët: Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës.

1. ANALIZA E SEKTORËVE NË NIVEL GLOBAL

Industria e Tekstilit, megjithëse e zhvilluar shumë si zanat, mbeti në thelb një industri e vogël deri në shekullin e 18 -të. Prodhimi masiv i tekstileve në shekullin e 18 -të ishte industria dominuese e revolucionit të parë industrial, dhe e para që përdori metoda moderne të prodhimit. Duke u bazuar në teknologji inovative si makina zhveshëse e pambukut, makina qepëse, prodhimi i mekanizuar i Tekstileve, Veshjeve, dhe Lëkurës drejtoi në mënyra të reja të organizimit të prodhimit dhe punës edhe në sektorë të tjerë.

Industritë shpejt u bënë fuqi ekonomike të vendeve të sapo industrializuara evropiane, duke kontribuar në rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës. Megjithatë, punëtorët në ndërmarrjet e tekstilit, numri më i madh i të cilëve ishin gra, u përballën me kushte të vështira pune, duke punuar me orë të gjata, dhe paga të ulëta, kurse në Evropë dhe Shtetet e Bashkuara shpesh punësonin punëtorë emigrantë në vendet e punës. Ndërsa ritmi i globalizimit u rrit me shpejtësi në vitet 1980, prodhimi i Tekstileve, Veshjeve, dhe Lëkurës u zhvendos në vendet në zhvillim ku kostoja e punës dhe prodhimit ishte e ulët.

Edhe sot, këta sektor kanë rol kyç në zhvillimin ekonomik dhe social të shumë vendeve në zhvillim dhe janë një pikë hyrëse në zinxhirët global të furnizimit dhe tregjet e eksportit. Këta sektorë me punë shumë intensive ofrojnë mundësi punësimi për miliona gra dhe burra dhe kanë ndihmuar miliona të tjerë të dalin nga varfëria.

Industria e Tekstilit punon në tre parime kryesore, përkatësisht në dizajnimin, prodhimin dhe shpërndarjen e materialeve të ndryshme. Një gamë e gjerë procesesh përdoren për të prodhuar linja të shumëllojshme të produkteve të gatshme dhe gjysmë të gatshme.

Rajoni i Azisë pacifike dominoi tregun e tekstilit dhe përbënte mbi 47.6% të të ardhurave globale në vitin 2020, për shkak të rritjes së vëllimit të shitjeve të veshmbathjeve dhe mallrave të veshmbathjeve. Përveç kësaj, prania e një numri të madh të klientëve në platformat e-commerce që blejnë veshmbathje dhe aksesore të ngjashëm në ekonomitë në zhvillim po shton më tej rritje pozitive në treg.

Në Evropë, kërkesa e tregut u vlerësua të ishte 83,298.8 kilotonë sa i përket vëllimit në vitin 2020 dhe pritet të rritet me një ritëm të konsiderueshëm gjatë viteve të ardhshme. Kjo rritje mund t'i atribuohet politikave të favorshme qeveritare dhe marrëveshjeve tregtare, siç janë marrëveshjet e tregtisë së lirë dhe Dialogu Euro-Mesdhetar mbi industrinë e Tekstilit dhe Veshjeve.

Rritja e preferencës së konsumatorit ndaj produkteve të qëndrueshme po detyron ndërmarrjet lidere të tregut të tekstilit të përqendrohen në ristrukturimin e biznesit të tyre dhe investimin në praktikë prodhuese që synojnë produkte të qëndrueshme dhe praktika me ndikim pozitiv në mjedis.

Pandemia COVID-19 ka prekur të gjitha vendet e Botës dhe industrinë të tëra në nivel global, dhe sektorët e Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës nuk bëjnë përjashtim. Tregu global i veshjeve është zvogëluar për 22%, duke shënuar rënie nga 1,635 miliardë dollarë në 2019 në 1,280 miliardë dollarë në vitin 2020. Konsumi pritet të arrij nivelet para-Covid gjatë dy viteve të ardhshme dhe pastaj të rimarr rrugën e rritjes së saj për të arritur në 2,007 miliardë dollarë deri në 2025.


Tabela 1.1. Tregu Global i veshjeve

Rajoni	2019	2020	V-në-V Ndryshimi	Projektimi CAGR 2019- 2025	2025 (P)
N. Botëror	1,635	1,280	-22%	3.50%	2,007
SHBA	235	171	-27	2%	265
Kina	181	173	-4%	11%	340
BE zona	264	219	-17%	1%	280
Japonia	106	83	-21%	0.50%	110
India	78	55	-29%	10%	135
Brazili	48	34	-30%	4%	60
Kanadaja	33	27	-19%	2%	37
Tjera	690	517	-25%	2%	780

Burimi: IMF World Economic Outlook Update, January 2021

Tregtia globale e Tekstilit dhe Veshjeve është rritur me një shkallë të përgjithshme të rritjes vjetore (CAGR) prej 4% që nga viti 2005 për të arritur në 839 miliardë dollarë në 2019 dhe pritet të arrijë 1 trilionë dollarë amerikanë deri në vitin 2025, duke u rritur me një normë të përgjithshme të rritjes vjetore (CAGR) prej 3%. Veshmbathja dominoi tregtinë e tekstilit dhe veshjeve prej 58% në vlerën e përgjithshme tregtare, e ndjekur nga pëlhura me 19%, dhe tekstilet shtëpiake 6%.

Figura 1.1. Vlera e tregtisë Globale të tekstilit dhe veshjeve sipas kategorisë (\$ miliardë dollarë Amerikan)



Burimi: UN Comtrade

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur pjesa e tregut sipas shteteve në lidhje me eksportin e tekstit dhe veshjes. Kina dominon me pjesën më të madhe të eksportit të tekstit dhe veshjeve në tregun global për vitin 2019, me 34%, vlerë që ka zbritur nga 39% saqë ishte në vitin 2015. Vietnami dhe Bangladeshi rënkohen numër 2 dhe 3 si eksportuesit më të mëdhenj të tekstit dhe veshjes në 2019. Nga kontinenti Evropian, Gjermania kryeson me 5% të pjesës së tregut global në eksport të tekstit dhe veshjeve për vitin 2019, dhe renditet vendi i katërt (4) më i madh në Botë.

Tabela 1.2. Pjesa e tregut Global të eksportit sipas shteteve në dollar Amerikan dhe %

Shtetet	Eksporti			Pjesa e tregut (%)
	Tekstil	Veshje	Total (US Milliard)	
Kina	136.6	149.9	284.5	34%
Vietnami	10.2	33.7	43.9	5%
Bangladeshi	1.8	40.9	42.7	5%
Gjermania	15.5	23.8	39.3	5%
India	20.2	16.2	36.4	4%
Italia	12.8	23.6	36.4	4%
Turkia	12.2	16.1	28.2	3%
SHBA	21.7	5.2	26.9	4%
Spanja	5	14.3	19.3	1%
Franca	5.6	12	17.6	2%
Tjerat	117.2	146.3	263.5	31%
Total	356.8	481.9	838.7	100%

Burimi: : IMF World Economic Outlook Update, January 2021

Në tabelën 1.3 kemi paraqitur një pasqyrë edhe më të detajuar sipas kategorive apo ndarjes së materialeve kryesore të përdorura në sektorët e Tekstit dhe Veshjeve.

Tabela 1.3. Eksportuesit kryesorë të Tekstit dhe Veshjes sipas kategorive

FIBRA	SHBA	Australia	Kina
Vlera e Eksportit (US\$ Bn)	6.67	3.30	3.12
Pjesa e tregut	20%	10%	9%
FIJE	Kina	India	Vietnami
Vlera e Eksportit (US\$ Bn)	5.53	3.69	3.17
Pjesa e tregut	21%	14%	12%

PËLHURË	Kina	Italia	Korea Jugore
Vlera e Eksportit (US\$ Bn)	72.70	7.57	7.26
Pjesa e tregut	45%	5%	5%

TEKSTILE SHTËPIAKE	Kina	India	Turqia
Vlera e Eksportit (US\$ Bn)	19.20	5.79	4.14
Pjesa e tregut	37%	11%	8%

VESHJE	Kina	Bangladeshi	Vietnami
Vlera e Eksportit (US\$ Bn)	149.90	40.90	33.70
Pjesa e tregut	31%	8%	7%


Burimi: : IMF World Economic Outlook Update, January 2021

Fillimi optimist i vitit 2020 u zbeh shpejt nga kriza e shkaktuar nga Covid-19 që bllokoi vendet në të gjithë globin, duke paralizuar zinxhirët e furnizimit dhe duke mbyllur sektorët e prodhimit dhe shitjes me pakicë. Ndikimi u ndje në të gjithë industrinë globale të Tekstilit, Veshjeve dhe Lëkurës me kërkesën në të gjitha destinacionet. Në fillim rënia e furnizimit ishte drastike duke u përmirësuar në mënyrë graduale.

Fibrat natyral mbizotëruan tregun e Tekstilit dhe përbëjnë mbi 44% të të ardhurave globale në vitin 2020, për shkak të përdorimit të tyre në aplikimin e larmishëm në industrinë e modës dhe veshjeve. Rritja e shqetësimeve për ambientin mjedisor së bashku me zhvendosjen e konsumatorit për të përdorur produkte të qëndrueshme pritet të rrisë kërkesën për fibra natyral, duke ndihmuar rritjen pozitive në treg. Poliesteri pritet të dëshmojë një normë rritjeje prej 4.2% nga 2021 deri në 2028, e cila mund t'i atribuohet vetive të tij të ndryshme siç është rezistenca e lartë kimike, rrudhave dhe tharja e shpejtë. Materiali nga poliesteri përdoret si material mbrojtës izolues në jastëkë dhe në industri për prodhimin e qilimave, filtrave të ajrit, pëlhurave të veshura dhe të tjera. Najloni është produkti i tretë më i madh i përdorur në industrinë e Tekstilit. Përdorimi i najlonit aplikohet për mobilimin e shtëpisë duke u bazuar në elasticitetin e lartë dhe vetive thithëse të lagështisë. Përveç kësaj, ajo vepron si zëvendësim për produktet e bazuara në mëndafsh siç janë: çorapet, parashutat, jelekët dhe të tjera.

Segmenti tjetër i produktit përfshin Polietileni (PE), Polipropileni (PP), Aramid dhe Poliamid. Karakteristikat e tyre siç janë: rezistenca e lartë kundër acideve dhe alkaleve në temperatura të larta dhe mbajtja minimale e lagështisë, kanë rritur kërkesën për polietilen në treg. Për më tepër, përdorimi i polipropilenit në industrinë e Tekstilit po shton rritje pozitive në treg.

Figura 1.2. Pjesa e tregut Global, sipas përdorimit 2020 (%)



Rritja e shpenzimeve të konsumatorëve për veshje në segmentin e modës mbizotërojnë tregun e Tekstilit, e cila përbën më shumë se 74% të pjesës së të ardhurave globale në vitin 2020. Kërkesat e larta të konsumatorit për pëlhuara të lyera dhe të shtypura, me cilësi në të gjithë globin, pritet të rrisë kërkesën e tregut global për tekstile nga 2021 deri në 2028.

Burimi: IMF World Economic Outlook Update, January 2021

Një rritje e kërkesës për veshje formale dhe jo-formale, si dhe veshje të tjera në modë në mesin e të gjitha grup moshave të popullsisë globale është faktori kryesor nxitës i rritjes për tregun. Për më tepër, rritja e popullsisë dhe urbanizimit në ekonomitë në zhvillim siç janë: India, Bangladeshi, Vietnami, Brazili dhe të tjera mund të rrisin kërkesën për veshje, duke kontribuar kështu pozitivisht në treg.

Kërkesa për tekstile në segmentin teknik pritet të rritet me një normë të konsiderueshme prej 3.7% gjatë periudhës së parashikuar, për shkak të vetive të tij me performancë të lartë dhe aplikacioneve të përdoruesve të fundit. Aplikimet në rritje në ndërtim, transport, veshje mjekësore dhe mbrojtëse kanë rritur përdorimin e të njëjtave, gjë që rrjedhimisht po nxit zgjerimin e tregjeve.

Përdorimi i tekstileve shtëpiake është një nga faktorët nxitës të rritjes të tregut. Kjo përfshin shtratin, tapiceri, qilima, lecka kuzhine, peshqir dhe të tjera. Për më tepër, konsumi i lartë i fibrave natyrore si liri dhe pambuku së bashku me fijet sintetike të përdorura për prodhimin e tekstileve shtëpiake po nxit më tej rritjen e tregut.

Tregu ka tendencë për rritje dhe zgjerim përmes grupimeve (kllasterëve) dhe blerjeve të ndërmarrjeve. Ndërmarrjet përpiqen të rrisin shitjet e tyre përmes marrëveshjeve të ndryshme tregtare dhe qeveritare dhe/apo në partneritet me portalet e tregtisë elektronike si Amazon, Flipkart, e-Bay dhe të tjerë.

Tregu është i fragmentuar për shkak të pranisë së disa prodhuesve të shkallës së vogël dhe të mesme, veçanërisht në vendet siç janë Kina dhe India. Për më tepër, disponueshmëria e lehtë e punës me kosto të ulët e shoqëruar me mbështetjen e qeverisë për krijimin e njësive të ndryshme të biznesit të lojtarëve kryesorë në vendet e lartpërmendura pritet të shtojë rritje pozitive në treg. Disa nga lojtarët e shquar në tregun e tekstilit përfshijnë: BSL limited (Indi), INVISTA S.R.L. (SHBA), Lu Thai Textile Co., Ltd. (Tajlandë), Paramount Textile Limited (Bangladesh), Paulo de Oliveira, S.A. (Portugali), Successori

REDA S.p.A. (Itali), Shandong Jining Ruyi Woolen Textile Co. Ltd., (Kinë), Sinopec Yizheng Chemical Fibre Company Limited (Kinë), China textiles Ltd., (Kinë) etj.

Sektorët e Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës janë rritur me shpejtësi gjatë dy dekadave të fundit, duke punësuar miliona punëtorë në të gjithë globin, pjesa më e madhe prej tyre janë gra. Ndikimet mjedisore janë përqendruar në pika të caktuara të zinxhirit të furnizimit, veçanërisht në katër fusha:

- Proceset e thurjes, ngjyrosjes dhe përfundimit në fabrikimin e tekstilit;
- Përdorimi i energjisë;
- Mbeturinat e tekstilit të lidhura me montimin e veshjeve; dhe
- Emetimet e transportit në të gjithë zinxhirin e furnizimit si materiale dhe më pas produktet përfundimtare dërgohen në nivel global.

Ndikimet më të theksuara, megjithatë, janë brenda dy fushave të para, me ndikimet kryesore që rrjedhin nga intensiteti i përdorimit të burimeve të ujit, përdorimi i kimikateve përfshirë kimikatat toksike, shkarkimet e ujërave të zeza dhe mungesa e proceseve të trajtimit, përdorimi i energjisë dhe intensiteti i lartë i karbonit të energjisë elektrike.

Prodhimi i tekstilit është i varur intensivisht ndaj ujit dhe kimikateve. Rritja dhe qëndrueshmëria e sektorit varet shumë nga mënyra se si menaxhohen burimet. Industria e tekstilit në përgjithësi përdor sasi të madhe uji duke filluar nga konsumi i ujit bujqësor për bujqësinë e pambukut, deri te konsumi i ujit në shtypjen, ngjyrosjen dhe përfundimin e tekstilit, dhe produkteve tjera.

Ky sektor është një nga përdoruesit më të mëdhenj të ujit të freskët në botë, duke konsumuar rreth 79 miliardë metra kub ujë të freskët në vit në të gjithë zinxhirin e vlerës⁵. Meqenëse prodhimi i tekstilit është i vendosur në disa vende që tashmë kanë furnizime të pasigurta me ujë, krizat e ujit parashikohen në vendet prodhuese të tekstilit, përfshirë Bangladeshin, Kamboxhia, Indinë, Indonezinë dhe Vietnamin. Gjithashtu është përgjegjës për ndotjen e rëndë të ujit duke shkarkuar vëllime të mëdha të ujërave të zeza që përmbajnë substanca të rrezikshme në lumenj dhe rrjedha të ujit pa trajtim të duhur. Raportohet se 20% e ndotjes industriale të ujit në nivel global i atribuohet ngjyrosjes dhe trajtimit të tekstileve.⁶

Gjurma e karbonit nga sektori është gjithashtu e rëndësishme, duke zënë 6-8% të emetimeve totale globale⁷. Në 2015 kjo u barazua me emetimet e 1.7 miliardë ton dioksid karboni⁸, që është më shumë se të gjitha fluturimet ndërkombëtare dhe transporti detar i kombinuar. Numrat nuk janë befasesh duke pasur parasysh faktin se mbi 60% e tekstileve përdoren në industrinë e veshjeve dhe një pjesë e madhe e prodhimit të veshjeve ndodh në Kinë dhe Indi. India mbështetet shumë në qymyr të fortë dhe gaz natyror për prodhimin e energjisë elektrike dhe nxehtësisë, duke rritur ndjeshëm gjurmët e secilit produkt veshjesh. Kalimi në energji të rinovueshme, të tilla si energjia diellore, hidro ose era, mund të zvogëlojë ndjeshëm emetimet dhe të përmirësojë qëndrueshmërinë e lidhur me prodhimin e tekstilit, veshjes dhe lëkurës.

⁵ Mbretëria e Bashkuar, Dhoma e përbashkët, Komiteti i Auditimit Mjedisor, 2019.

⁶ FEM (Fondacioni Ellen Macarthur). Një ekonomi e re e tekstileve: Ridizajnimi i së Ardhmes së Modës, 2017.

⁷ ILO, Maj 2021.

⁸ Idib.

2. PASQYRË E SEKTORËVE TË TEKSTILIT, VESHJES DHE LËKURËS NË NIVEL VENDOR

Shteti i Kosovës është i pozicionuar në juglindje të kontinentit evropian, gjegjësisht në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik. Kushtet natyrore dhe pozita e favorshme gjeografike, mundësojnë potencial të madh për zhvillimin ekonomik dhe industrial. Në anën tjetër, faktorët e tjerë kyç të lidhur ngushtë me aspektin politik dhe të kaluarën nga pushtimet e vazhdueshme, kanë ndikuar që Kosova sot të jetë ndër vendet me zhvillim ekonomik dhe industrial më të ngadalësuar. Në fazën fillestare, që përfshin vitet e '50 të shekullit XIX, struktura e industrisë kosovare ka qenë shumë e thjeshtë dhe me një numër të vogël degësh të zhvilluara. Në mesin e 11 degëve më të zhvilluara të asaj kohë bën pjesë dhe industria e Tekstilit, metalurgjia me ngjyra, industria e materialeve ndërtimore etj⁹.

Me zhvillimin e degëve të reja industriale, sidomos atyre përpunuese, struktura e degëve industriale në Kosovë ndryshoi dukshëm. Në bazë të të dhënave të vitit 1987, ndër degët që krijuan vlerë më të lartë të qarkullimit bën pjesë metalurgjia me ngjyra, prodhimi i makinave, industria e lëkurë këpucëve etj. Deri në vitet '80, këto industri arritën nivel të konsiderueshëm zhvillimi, mirëpo për shkak të situatës kritike të viteve '90, u shënua ngecje në zhvillim, prodhim, punësim dhe eksport. Kjo fazë dhe lufta që do të pasonte, ndikuan në rënien pothuajse të plotë të industrisë së sektorëve shtetëror-shoqëror.

Industria e Tekstilit është një ndër degët e para të zhvilluara, e përhapur në disa qendra të Kosovës. Gjatë asaj periudhe prodhoheshin fije pambuku, fije leshi, pëlhura sintetike, trikotazhe, konfeksione, perde dhe qilima. Kjo industri ka vazhduar zhvillimin e saj ndër vite duke rritur numrin e ndërmarrjeve prodhuese, zgjeruar rrjetin e produkteve të shitura dhe njëkohësisht ka ndikuar në rritjen e të punësuarve.

2.1 Prodhimi i Tekstilit

Në veçanti industria e Tekstilit ka filluar të marr hovin e saj pas vitit 1999, falë traditës, kreativitetit dhe përvojës të shumë familjeve kosovare të cilat kanë themeluar ndërmarrje private për përpunimin e lëkurave, gëzofëve, mbathjeve,thurjes, endjes dhe qepjes.

Prodhimi i Tekstilit është një ndër sektorët i cili premton zgjerim të mëtutjeshëm në numrin e ndërmarrjeve, numrin e të punësuarve dhe qarkullimit për eksport njëkohësisht si rezultat i kërkesës së pandalshme nga tregu qoftë i jashtëm dhe i brendshëm.

Në vendin tonë aktualisht operojnë afro 173 ndërmarrje të cilat kanë të punësuar rreth 802 punëtorë formal, numër ky i cili shënon rritje krahasuar me dy vitet e kaluara meqë në vitin 2018 kishim 127 ndërmarrje aktive me 817 punëtorë, ndërsa në vitin 2019 kishim 111 ndërmarrje aktive me 627 punëtorë të sektorëve të prodhimit të Tekstilit.

⁹ Sektori i industrisë së përpunimit të Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës, Kiesa, 2019

Të njëjtat ndërmarrje arrijnë qarkullimin vjetor mbi 16.06 milion euro, përkundër situatës pandemike në të cilën gjendemi. Rajonet në të cilat këto ndërmarrje janë më shumë të përqendruara janë Prishtina, Ferizaji, Prizreni dhe Gjakova. Ndërsa produktet e tyre kryesisht eksportohen në vendet e BE-së dhe CEFTA-së. Të dhënat e detajuara lidhur me sektorin prodhimi i Tekstilit gjeni në tabelën e mëposhtme;

Tabela 2.1. Pasqyrë e përgjithshme e prodhimit të Tekstilit në kontekstin vendor

Kodi	Sektori (13)-të Prodhimi i Tekstilit	Numri i ndërmarrjeve			Numri i të punësuarve			Qarkullimi		
		18	19	20	18	19	20	2018	2019	2020
1310	Përgatitja dhe thurja e fijeve të tekstilit	10	9	14	13	14	17	41,747.06	56,682.82	48,369.60
1320	Endja e tekstilit	11	9	11	77	70	76	2,237,604.04	2,927,144.22	2,273,755.62
1330	Proceset përfundimtare të përpunimit të tekstilit	32	29	44	358	172	254	5,755,599.36	6,046,688.34	6,893,915.44
1391	Prodhimi i pëlhurave të thurura dhe të endura	6	4	4	13	6	5	37,386.77	46,730.27	25,672.38
1392	Prodhimi i artikujve të tekstilit të konfeksionuar përveç veshjeve	10	8	10	53	57	55	1,821,818.51	1,752,403.58	1,436,549.07
1394	Prodhimi i qilimave, sixhadeve dhe tepihëve	3	3	3	70	27	59	810,232.14	476,332.29	1,068,044.26
1395	Prodhimi i litarëve, spangove dhe rrjetave	-	-	1	-	-	1	-	-	745.00
1396	Prodhimi i pëlhurave të pa endura dhe artikujve të pa endur, përveç veshjeve	1	1	1	4	3	4	-	2,400.00	900.00
1399	Prodhimi i tekstileve të tjera teknike dhe industriale	4	4	6	24	25	27	699,221.89	832,652.48	1,004,119.08
	Prodhimi i tekstileve të tjera p.k.t	50	44	79	205	255	304	3,284,376.11	3,241,929.26	3,312,334.39
GJITHSEJ		127	111	173	817	629	802	14,687,985.88	15,382,963.26	16,064,404.84

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/MINT

Për sa i përket eksportit në sektorin “Prodhimi i Tekstilit” vërehet dukshëm që viti 2020 ka shënuar rritje për 56% të vlerës totale të eksportit krahasuar me vitin paraprak. Vlera totale e eksportit për vitin 2020 ishte 17.94 milion euro, përfshirë këtu eksportin e mallrave të përgatitjes dhe thurjes së fijeve, endja e tekstilit dhe prodhimi i tekstileve të tjera. Ndërsa eksporti me vendet e BE-së është 21.4%, me vendet e CEFTA-së 29%, EFTA-së 2.64% dhe vendet e tjera me 47%.

Tabela 2.2. Vlera e tregut vendor të eksportit për prodhimin e tekstilit në Euro dhe %

Kodi	Sektori Prodhimi i Tekstilit	Eksporti			Ndryshimi në vlerë	Ndryshimi në %
		2018	2019	2020		
13	Prodhimi i Tekstilit	6,136,824.19	7,875,908.03	17 948 552,72	10 072 644,14	127.89
13.1	Përgatitja dhe thurja e fijeve të tekstilit	509,170.62	137,430.84	674,710.00	537,278.88	390.94
13.2	Endja e tekstilit	511,127.80	1,416,543.36	1,845,939.00	429,396.08	30.31
13.9	Prodhimi i tekstileve të tjera (me aktivitetet: 9.1,9.2,9.3,9.4,9.5,9.6,9.9)	5,116,525.77	6,321,933.83	15,427,903.00	9,105,969.18	144.04

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/MINT

Duke pas parasysh rritjen e qarkullimit vjetor për vitin 2020, njëkohësisht është rritur dhe vlera e importit në vendin tonë. Të dhënat tregojnë se në vitin 2019 importet e lëndës së parë kanë qenë në vlerë prej 56.79 milion euro, ndërsa në viti 2020 janë 66.66 milion euro, që paraqet një rritje prej 9.87 milion euro.

Tabela 2.3. Vlera e tregut vendor të importit për prodhimin e tekstilit në Euro dhe %

Kodi	Sektori Prodhimi i Tekstilit	Importi			Ndryshimi në vlerë	Ndryshimi në %
		2018	2019	2020		
13	Prodhimi i Tekstilit	58,660,751.55	56,796,552.95	66 662 771,63	9,866,218.68	17.37
13.1	Përgatitja dhe thurja e fijeve të tekstilit	1,123,102.91	1,222,642.44	1,395,265.48	172,623.04	14.12
13.2	Endja e tekstilit	15,814,106.35	16,208,427.98	15,258,306.34	-950,121.64	-5.86
13.9	Prodhimi i tekstileve të tjera (me aktivitetet: 9.1,9.2,9.3,9.4,9.5,9.6,9.9)	41,723,542.29	39,365,482.53	50,009,199.81	10,643,717.28	27.04

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/MINT

2.2. Prodhimi i Veshjes

Ndërmarrjet prodhuese në sektorin e Veshjes, ndahen në tri kategori: prej, bëj dhe shkurtoj e cila njihet dhe si prej, qep dhe fason. Ky sektor është ndër më të zhvilluarit krahasuar me sektorët e Tekstilit dhe Lëkurës dukë përbërë numrin më të lartë të ndërmarrjeve, të punësuarve dhe njëkohësisht qarkullimit vjetor, si në vendin tonë ashtu dhe në vendet e tjera.

Në kuadër të këtij sektori prodhimi i Veshjeve serike si uniformave të profesioneve të ndryshme për punë është ndër produktet me numër më të lartë të prodhimit. Përveç të qenurit intensiv në punë, vlen të theksohet se në këtë sektor dominon pronësimi dhe punësimi i gjinisë femërore.

Sektori “Prodhimi i Veshjes” sipas të dhënave të pranuar nga Agjencionit të Statistikave të Kosovës, për vitin 2020, ka shënuar rritje në krahasim me dy vitet paraprake. Numri i ndërmarrjeve aktive për vitin 2020 ishte 325 ndërmarrje të cilat numërojnë 1151 të punësuar me vlerë qarkullimi prej 9,95 milion euro.

Tabela 2.4. Pasqyrë e përgjithshme e prodhimit të veshjes në kontekstin vendor

Kodi	Sektori (13)-të Prodhimi i Veshjes	Numri i ndërmarrjeve			Numri i të punësuarve			Qarkullimi		
		18	19	20	18	19	20	2018	2019	2020
1310	Prodhimi i veshjeve të lëkurës	3	4	6	55	2	5	163,510.37	45,649.68	43,379.40
1320	Prodhimi i veshjeve të punës	32	28	40	158	204	336	1,245,523.05	2,254,721.10	2,740,757.66
1330	Prodhimi i veshjeve të tjera të jashtme	126	117	189	494	503	611	4,265,857.81	4,388,924.98	4,852,617.33
1391	Prodhimi i veshjeve të brendshme	1	1	4	3	3	11	63,959.37	58,660.51	239,725.57
1392	Prodhimi i veshjeve të tjera dhe atyre plotësuese (dorëzave, kapelave, shalleve etj.)	31	27	44	109	112	143	1,191,889.37	1,298,806.18	1,635,999.21
1394	Prodhimi i artikujve nga gëzofi		2	1		2	2		21,787.00	10,969.42
1395	Prodhimi i çorapeve të thurura	5	4	6	12	11	13	210,419.63	251,713.33	221,612.30
1396	Prodhimi i rrobave të tjera të thurura ose të punuara me grep	28	28	35	26	19	30	167,801.45	194,693.41	213,615.94
GJITHSEJ		226	210	325	857	856	1151	7,308,961.05	8,514,956.19	9,958,676.83

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/MINT

Eksporti në sektorin “Prodhimi i veshjes” ka shënuar rritje të konsiderueshme në tre vitet e fundit, ndërsa vlen të theksohet se në vitin 2020 ka shënuar rritje më të lartë krahasuar me dy vitet paraprake. Viti 2020 shënon vlerën prej 5.15 milion euro të eksportit, përderisa viti 2018 ka shënuar 3.2 milion euro vlerë për eksport ndërsa viti 2018 ka shënuar 2.17 milion euro vlerë për eksport.

Vlera totale e eksporteve të ky sektorë për vitin 2020 është 5.15 milion euro, përderisa eksporti me vendet e BE-së është 38%, me vendet e CEFTA-së 9.4%, EFTA-së 7% dhe vendet tjera 46%. Produktet e sektorit “Prodhimi i veshjeve”, në vendet e BE-së, më së tepërmi janë eksportuar në Itali me 30% dhe në Gjermani me 25%. Sa i përket vendeve të CEFTA-së, produktet e sektorit Prodhimi i Veshjeve më së tepërmi janë eksportuar në Maqedoninë e Veriut me 43.3% dhe Mal të Zi me 24%. Ndërsa në vendet e EFTA-së, produktet e sektorit Prodhimi i Veshjeve janë eksportuar në Zvicër me 99%, ndërsa në vendet e tjera më së tepërmi është eksportuar në SHBA me 72%.

Tabela 2.5. Vlera e tregut vendor të eksportit për prodhimin e veshjeve në Euro dhe %

Kodi	Sektori Prodhimi i Veshjes	Eksporti			Ndryshimi në vlerë	Ndryshimi në %
		2018	2019	2020		
13	Prodhimi i veshjeve, përveç veshjeve të gëzofit	2,179,544.62	3,293,023.19	5,156,424.31	1,863,401.15	56.59
13.1	Prodhimi i veshjeve, përveç veshjeve të gëzofit	1,942,304.25	2,713,627.99	4,629,931.00	1,916,303.32	70.62
13.2	Prodhimi i artikujve nga gëzofi	0	0	0	-	-
13.9	Prodhimi i rrobave të thurura me grep	237,240.37	579,395.20	526,493.03	-52,902.17	-9.13

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/MINT

Përkundër vlerës së rritur të numrit të ndërmarrjeve, numri të punësuarve dhe qarkullimit vjetor, vlen të theksohet se vlera e importit në sektorin e veshjeve, për vitin 2020 është vlerë më e ulët krahasuar me vitet paraprake. Viti 2020 shënon 98.7 milion euro të importit, përkundër vitit 2018 ku vlera totale e importit ishte 118 milion euro dhe vitit 2018 në të cilin janë importuar materiale që arrijnë vlerën 105.17 milion euro. Importi në vendet e BE-së është 6%, me vendet e CEFTA-së 2%, EFTA-së 0.11% dhe me vendet e tjera 92%.

Tabela 2.6. Vlera e tregut vendor të importit për prodhimin e Veshjes në Euro dhe %

Kodi	Sektori Prodhimi i Veshjes	Importi			Ndryshimi në vlerë	Ndryshimi në %
		2018	2019	2020		
13	Prodhimi i veshjeve, përveç veshjeve të gëzofit	105,171,177.93	118,008,278.57	98,738,284.03	-19,269,994.54	-16.33
13.1	Prodhimi i veshjeve, përveç veshjeve të gëzofit	88,060,654.36	100,177,489.64	82,365,196.68	-17,812,292.96	-17.78
13.2	Prodhimi i artikujve nga gëzofi	25,687.91	23,558.64	15,377.12	-8,181.52	-34.73
13.9	Prodhimi i rrobave të thurura me grep	17,084,835.66	17,807,230.29	16,357,710.23	-1,449,520.06	-8.14

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/MINT

2.3. Prodhimi i Lëkurës dhe Produkteve prej Lëkurës

Gjeneza e sektorit të Lëkurës në Kosovë është në traditën e regjësve të lëkurës dhe saraçevë për përpunimin e lëkurës dhe prodhimin e këpucëve që nga viti 1945.

“Lëkura dhe produktet nga lëkura” është sektori më i favorshëm në punësim, me lëvizje të lehtë gjatë tri viteve të fundit. Nga ky rezultat është analizuar numri i ndërmarrjeve, të punësuarve si dhe qarkullimi vjetor për vitet 2018 – 2020. Në këtë sektor, gjatë vitit 2020, numri i ndërmarrjeve ka qenë 43, numri i të punësuarve ishte 420, dhe qarkullimi vjetor arrin në vlerën prej 5.81 milion euro. Krahas vitit 2019 ky sektor ka shënuar rritje në punësim, numër të ndërmarrjeve ndërsa rënie në qarkullim vjetor.

Tabela 2.7. Pasqyrë e përgjithshme e prodhimit të Lëkurës në kontekstin vendor

Kodi	Sektori (14)-të Prodhimi i Lëkurës	Numri i ndërmarrjeve			Numri i të punësuarve			Qarkullimi		
		18	19	20	18	19	20	2018	2019	2020
1511	Tanimi dhe regjja e lëkurës; veshja dhe ngjyrosja e gëzofit	2	1	2	4	0	3	10,500.40	9,647.20	33,664.85
1512	Prodhimi i valixheve, çantave dhe gjësendeve të ngjashme si takëmeve të kuajve dhe parzmoreve	11	9	14	31	38	40	706,814.59	872,234.49	800,745.93
1520	Prodhimi i këpucëve	24	19	27	395	341	377	6,095,315.47	6,274,768.69	4,982,531.90
GJITHSEJ		37	29	43	430	379	420	6,812,630.46	7,156,650.38	5,816,942.68

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/MINT

Totali i vlerës së eksporteve tek sektori “Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës” arrin në 2.33 milion euro. Produktet eksportohen kryesisht në vendet e BE-së me 61.77%, në vendet e CEFTA-së me 37.56% ndërsa në një përqindje shumë më të ulët në vendet e EFTA-së me 0.19% dhe në vendet e tjera me vetëm 0.48%. Vendet në të cilat më së tepërmi janë eksportuar produktet e këtij sektori janë në Francë me 29.64%, në dhe në Shqipëri me 28.57%. në Poloni me 22.96%

Tabela 2.8. Vlera e tregut vendor të eksportit për prodhimin e lëkurës dhe produkteve të lëkurës në Euro dhe %

Kodi	Sektori Prodhimi i Lëkurës	Eksporti			Ndryshimi në vlerë	Ndryshimi në %
		2018	2019	2020		
13	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës	2,735,479.11	3,080,819.54	2,335,813	-745,006.77	-24.18
13.1	Tanimi dhe regjja e lëkurës; prodhimi i va ligjeve ,çantave ,takëmeve te kuajve dhe	956,459.59	846,035.43	119,632	-726,403.63	-85.86

	takëmeve të tjerë ,veshja dhe ngjyrosja e gëzofit					
13.2	Prodhimi i këpucëve	1,779,019.52	2,234,784.11	2,216,181	-18,603.14	-0.83

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/MINT

Ndërsa sa i përket importit të këtij sektori, vlera totale për vitin 2020 arrin 38.21 milion euro, importi me vendet e BE-së është 8.49%, me vendet e CEFTA-së 3.2%, EFTA-së 0.15% dhe vendet e tjera me 88.16%. Vendet nga të cilat janë importuar më së tepërmi produktet e këtij sektori janë Kina me 38.12%, nga Turqia me 21.55%, nga Vietnami me 14.88% etj.

Tabela 2.9. Vlera e tregut vendor të importit për prodhimin e lëkurës dhe produkteve të lëkurës në Euro dhe %

Kodi	Sektori Prodhimi i Lëkurës	Importi			Ndryshimi në vlerë	Ndryshimi në %
		2018	2019	2020		
13	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	44,554,440.03	49,380,964.63	38,212,879.80	-11,168,084.83	-22.62
13.1	Tanimi dhe regjja e lëkurës; prodhimi i valixheve, çantave, takëmeve të kuajve dhe takëmeve të tjerë ,veshja dhe ngjyrosja e gëzofit	8,857,972.36	9,418,650.59	6,408,762.01	-3,009,888.58	-31.96
13.2	Prodhimi i këpucëve	35,696,467.67	39,962,314.04	31,804,117.79	-8,158,196.25	-20.41

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/MINT


Analizë përmbledhëse e tre sektorëve, për numrin e ndërmarrjeve, të punësuarve dhe qarkullimit

Sektorët e Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës, ndër vite kanë dëshmuar se janë sektorë me potencial të rritjes në mënyrë të vazhdueshme të numrit të ndërmarrjeve aktive, numrit të të punësuarve dhe qarkullimit vjetor. Për të nxjerrë këtë konkluzion janë analizuar të dhënat për numrin e ndërmarrjeve, numrit e të punësuarve dhe qarkullimit për tre vitet e fundit për sektorët e Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës. Sipas këtyre të dhënave është kuptuar se viti 2018 në total kishte 390 ndërmarrje prodhuese aktive, në vitin 2019 kishte 350 ndërmarrje prodhuese ndërsa në vitin 2020 kishte 540 ndërmarrje të cilat kanë ushtruar veprimtarinë e prodhimit të produkteve të Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës.

Sa i përket numrit të të punësuarve, ndërmarrjet prodhuese të vitit 2018 kanë pasur 2,104 të punësuar, ndërmarrjet prodhuese të vitit 2019 kishte 1,864 të punësuar dhe ndërmarrjet prodhuese të viti 2020 kishte 2,373 të punësuar. Vlen të theksohet se përkundër zvogëlimit të numrit të ndërmarrjeve nga viti 2018 në vitin 2019, numri i të punësuarve nuk është zvogëluar.

Rritje është vërejtur dhe në vlerën e qarkullimit ndër vite, viti 2018 ka shënuar 28.809 milion euro qarkullim, viti 2019 ka shënuar 31.054 milion euro qarkullim dhe viti 2020 ka shënuar 31.840 milion euro qarkullim.


Figura 2.1. Numri i ndërmarrjeve në tre sektorët



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga D&D Business Support Center

Për të analizuar trendet e numrit të ndërmarrjeve në mënyrë më specifike janë analizuar të dhënat për tre vitet e fundit, 2018-2020. Në sektorin për prodhimin e Tekstilit në vitin 2019 krahas vitit 2018 vërehet një rënie më e lehtë e numrit të ndërmarrjeve (7.07%), mirëpo kur e krahasojmë me vitin 2020 shohim një rritje të theksuar të numrit të ndërmarrjeve (54.76%). Tek prodhimi i veshjeve vërehen luhatje të lehta (12.5%) kur krahasojmë vitin 2019 me vitin 2018, mirëpo krahas vitit 2020 shohim se prodhimi i veshjeve ka pasur rritje (55.85%) të numrit të ndërmarrjeve. Në sektorin e prodhimit të lëkurës krahasuar me dy të tjerat nuk kishte shumë ndryshime aq të theksuara, mirëpo numri i ndërmarrjeve ishte i pa ndryshuar. Viti 2019 krahasuar me vitin 2018 kishte rënie (27.5%) të numrit të ndërmarrjeve ndërsa në vitin 2020 është shënuar rritje (44.82%) të numrit të ndërmarrjeve.

Figura 2.2. Numri i të punësuarve në tre sektorët




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga D&D Business Support Center

Përveç numrit të ndërmarrjeve, është bërë edhe analiza e numrit të punësuarve ndër vite në tre sektorët, në prodhimin e Tekstilit, prodhimin e Veshjes dhe prodhimin e Lëkurës. Sektori i Tekstilit në numrin e të punësuarve gjatë vitit 2019 kishte rënie të theksuar krahas vitit 2018 por në vitin 2020 kishte rritje duke e kthyer këtë numër të punëtorëve në pikën e përafërt me vitin 2018.

Prodhimi i Veshjes ndër vite kishte shënuar vetëm rritje në numrin e të punësuarve, rritje më të lehtë kishte nga viti 2018 në 2019, mirëpo rritja më e lartë duke krahasuar edhe me dy sektorët e tjerë ishte nga viti 2019 në 2020 si dhe prodhimi i Lëkurës, i cili paraqet një rënie të lehtë të numrit të punësuarve në vitin 2019, e cila rikthehet në vitin 2020 në pikën paraprake të vitit 2018.

Figura 2.3. Qarkullimi në tre sektorët



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga D&D Business Support Center

Trendi i qarkullimit të ndërmarrjeve, sipas të dhënave të pranuar nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës paraqet një ngritje konstante në prodhimin e Tekstilit nga viti 2018, 2019 dhe 2020 edhe pse në vlera mjaft modeste. Prodhimi i Veshjes po ashtu ka paraqitur rrjedhë pozitive të qarkullimit në vitet e analizuara, ndërsa vërehet një ngritje më theksuar në vitin 2020. Përkundër dy sektorëve të tjerë të prodhimi i Lëkurës për të njëjtin afat kohorë vërehet rritje e vlerës së qarkullimit vetëm në vitin 2019, kurse në vitin 2020 është shënuar rënie e theksuar e qarkullimit në këtë sektorë.

3. ANALIZA E ZINGJIRIT TË VLERËS

Analiza e Zingjirit të Vlerës është bazuar kryesisht nga gjetjet e të dhënave primare, ku janë realizuar 81 intervista me ndërmarrjet prodhuese, furnizuese dhe transportuese të produkteve të Tekstilit, Veshjeve dhe Lëkurës. Gjithashtu janë realizuar gjithsej 9 intervista me akterët relevant përfaqësues institucione dhe organizata të ndryshme të cilët kanë përkrahur sektorët e Tekstilit Veshjes dhe Lëkurës. Vlen të theksohet se disa nga ndërmarrjet në Zingjirin e Vlerës të këtij sektori, kryejnë më shumë se një funksion.

Me qëllim të pasqyrit sa më real të gjendjes së këtyre sektorëve, intervistat janë realizuar bazuar në 4 kategori/pyetësorë të veçantë:

1. Pyetësori për akterët e sektorëve të Tekstilit, Veshjeve dhe Lëkurës,
2. Pyetësori për ndërmarrjet prodhuese,
3. Pyetësori për ndërmarrjet furnizuese,
4. Pyetësori për ndërmarrjet transportuese.

Njëkohësisht me qëllim që hulumtimi të jetë sa më gjithëpërfshirës është bërë intervistimi i ndërmarrjeve në 21 komunat e Republikës së Kosovës në të cilat sektorët e Tekstilit, Veshjeve dhe Lëkurës janë më të zhvilluar.

Nga numri i përgjithshëm i intervistave të realizuara në këtë hulumtim, 72% e ndërmarrjeve janë prodhuese, 12% e ndërmarrjeve janë furnizuese, 6% prej të intervistuarve janë ndërmarrje transportuese, dhe 10% janë akterë relevant të sektorëve të Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës.

Fig.1 Struktura e ndërmarrjeve sipas regjionit /






Fig.2 Struktura e ndërmarrjeve sipas veprimtarisë



Harta e Zingjirit të Vlerës

Në figurën 3.1 është përshkruar Harta e Zingjirit të Vlerës për sektorët e Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës. Harta e Zingjirit të Vlerës është e përbërë nga tre (3) funksione kryesore, të cilat gjithashtu kanë qenë pjesë e fokusit të studimit.

Figura 3.1. Harta e Zingjirit të Vlerës për sektorët e Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës



Furnizimi (perspektiva e prodhuesit)

Sektorët e Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës në Kosovë nuk janë ekskluzivisht të ndarë në një funksion të vetëm biznesor, pasi që në përgjithësi ato kryejnë më shumë se një funksion të Zingjirit të Vlerës.

Numri më i madh i ndërmarrjeve prodhuese, respektivisht 82%, bashkëpunojnë me 1 deri në 3 furnizues/importues, ndërsa pjesa tjetër prej 18% bashkëpunojnë me më shumë se 4 ndërmarrje furnizimi të ndryshme. Një numër i madh i ndërmarrjeve prodhuese, importin e produkteve apo materialeve të nevojshme e bëjnë direkt në baza vetanake, ky funksion i Zingjirit të Vlerës është më i theksuar veçanërisht në importin e materialeve të nevojshme për prodhim dhe aksesore.

Sa i përket procesit të importit, 53% e ndërmarrjeve preferojnë që furnizimi me materiale/produkte të bëhet në baza vetanake, ndërsa pjesa tjetër prej 47% mendojnë se organizimi i procesit të importit është më i preferueshëm të bëhet përmes ndërmjetësueseve. Nga perspektiva e ndërmarrësve ata theksojnë disa faktorë primar që i shtyjnë të organizojnë furnizimin në baza vetanake, ndër to janë: fleksibiliteti, kostoja, dhe siguria e furnizimit.

Nga ana tjetër në lidhje me produktet me të cilat furnizohen ndërmarrjet prodhuese nga furnitorët, 40% e ndërmarrjeve prodhuese, kryesisht bëjnë blerjen e materialeve të nevojshme për përpunim, 30% e ndërmarrjeve bëjnë blerjen e aksesorëve të ndryshëm dhe 29% bëjnë blerjen e produkteve si lëndë e parë e nevojshme për prodhim.

Materialet më të përdorura për ndërmarrjet prodhuese krahas llojit të produkteve të cilat prodhojnë janë: sateni 20% e ndjekur nga pambuku me 17%, likër me 15%, si dhe tutje janë përmendur materiali mëndafsh me 13%, materiali gomë me 9%, leshi me 9% etj.

Tabela 3.1. Produktet kryesore të prodhuara

Produktet e prodhuara	Lënda e parë
Veshje/rroba	Mëndafsh, saten, liker, pambuk, lesh, plish, shtof etj.
Mbathje	Lëkura, fije sintetike, gomë, pambuk etj.
Tekstile shtëpiake	Pambuk, sintetika, sfungjer, mëndafsh, gomë, plish etj.

Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Pasi që rëndësi të veçantë për ndërmarrjet prodhuese të tekstilit, veshjes dhe lëkurës paraqet origjina e importeve me lëndë të parë, të dhënat e këtij studimi tregojnë se vendi dominues i këtyre ndërmarrjeve për furnizim me lëndë të parë është Turqia. Ndërsa vendet tjera të cilat janë përmendur si burim i materialeve të nevojshme për ndërmarrjet prodhuese por në përqindje më të ulët janë Kina, Bullgaria, Italia, Gjermania etj.

Sa i përket sasisë së materialeve apo produkteve të importuara për ndërmarrjet e tyre, duke krahasuar vitin 2019 me vitin 2020, është vërejtur se importi i produkteve në vitin e fundit (2020) ishte më i ulët. Pandemia Covid-19 ka ndikuar në ndërprerjen e përkohshme të aktiviteteve të punës, nga 12 ndërmarrje në vitin 2019 që kanë importuar 100% të materialeve nga tregu i jashtëm, në vitin 2020 janë vetëm 8 sosh. Ngjashëm është rënia e pothuajse të gjitha ndërmarrjeve të cilat kanë importuar nga

jashtë, përveç atyre ndërmarrjeve të cilat kanë importuar nga të dy burimet e furnizimit (nga tregu i jashtëm dhe ai vendor) është vërejtur ngritje e përqindjes së materialeve/produkteve të importuara nga jashtë apo duke u furnizuar në baza vetanake nga tregu i jashtëm.

Ndër pengesat më të theksuara të cilat ndërmarrjet prodhuese hasin gjatë furnizimit me materialet e nevojshme janë: furnizimi me lëndë të parë, e cila konsiderohet ndër sfidat më të theksuara me 31% e përgjigjeve e ndjekur nga transporti me 25% të përgjigjeve, kohën e furnizimit me 17%, pjesa tjetër prej 16% konsiderojnë si sfidë procedurat administrative dhe doganore dhe 11% e përgjigjeve tregojnë se cilësia është gjithashtu pengesë e theksuar në procesin e furnizimit me material.

Furnizimi (perspektiva e furnizuesve)

Për qëllim të këtij studimi 12%, respektivisht 11 NVM nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të intervistuar për këtë hulumtim janë ndërmarrje të cilat kanë aktivitet kryesor furnizimin me materiale/ produkte dhe aksesore të ndërmarrjeve prodhuese të tekstilit, veshjes dhe lëkurës.

Nga 11 ndërmarrje furnizuese, 46% (5) ndërmarrjeve furnizohen nga tregjet vendore dhe ato ndërkombëtare, 27% (3) e ndërmarrjeve furnizohen me material vetëm nga tregu i jashtëm, dhe për 27% (3) të ndërmarrjeve të cilat kanë treguar se furnizohen me material të nevojshme vetëm nga tregu vendor.

Siç shihet në tabelën e mëposhtme, ndërmarrjet që furnizohen me materialet kryesore nga tregu i jashtëm janë: pambuku me 31%, e përcjellur nga lëkurat me 15%, fibrat, leshi dhe produkte finale me nga 12%. Ndërsa, ndërmarrjet të cilat furnizohen nga tregu vendor në përgjithësi furnizohen me produkte finale të cilat më pas i dërgojnë për shitje në dyqanet me pakicë.

Tabla 3.2. Furnizimi i materialeve

Furnizimi me material nga tregu i jashtëm	Përqindja (%)
Pambuku	30.77%
Lëkura	15.38%
Fibrat	11.54%
Leshi	11.54%
Produkte finale	11.54%
Llani	7.68%
Penjë për qëndisje	3.85%
Përzierje pambuk - polister	3.85%
Likër, gomë	3.85%
Total	100%

Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Origjina e importeve për ndërmarrjet furnizuese është Turqia, që përbën 50% të të gjitha importeve të ndërmarrjeve në këtë sektor pastaj e përcjellur nga Bullgaria me 22%, Kina me 10% etj. Një ndër arsytet pse ndërmarrjet vendore preferojnë Turqinë për furnizim të materialeve është pozita e afërt gjeografike, kostot e transportit si dhe kualiteti i produkteve. Kostoja e procedurave doganore

konsiderohet si kostoja e dytë e procesit të importit të produkteve/materialeve të nevojshme për ndërmarrjen pas kostonë së transportit, përcjellur nga detyrime tjera.


Shtytjet primare të ndërmarrjeve të cilat përzgjedhin importin e produkteve dhe materialeve nga tregu i jashtëm janë çmimet më të favorshme. Nga materiali i tregut të jashtëm në përgjithësi përfitimet konsiderohen të jenë më të kënaqshme, kjo përfshinë 73% e përgjigjeve nga të anketuarit ndërsa 27% e të anketuarve konsiderojnë se përfitim më pak i kënaqshëm është nga materiali vendor.

Për sa i përket organizimit të importit të lëndës së parë nga numri i përgjithshëm i të anketuarve në këtë studim, 67% (6 NVM) e ndërmarrjeve kanë deklaruar se plotësisht e organizojnë importin në baza vetanake, 11% (1 NVM) prej tyre pjesërisht e organizojnë importin në baza vetanake, 11% (1 NVM) e ndërmarrjeve kryejnë furnizimin me lëndë të parë përmes ndërmjetësuesve dhe gjithashtu 11% (1 NVM) të ndërmarrjeve përdorin metodën miks sipas nevojës. Të dhëna thuajse të ngjashme me importin e lëndës së parë është dhe organizimi i deponimit, ku sipas përgjigjeve të pranura nga ndërmarrjet, është kuptuar se 73% e të anketuarve procedurën e deponimit e kryejnë plotësisht në baza vetanake, 9% këtë shërbim e kryejnë pjesërisht në baza vetanake ndërsa 18% prej tyre organizimin e deponimit e kryejnë nëpërmjet ndërmjetësuesve të jashtëm të cilët ofrojnë këto shërbime.

Forma më e preferuar për importin e lëndës së parë është organizimi i importit në baza vetanake, e mbështetur nga 64% e ndërmarrjeve (7 NVM). Pjesa tjetër prej 36% e konsiderojnë si formë më të preferuar importin përmes ndërmjetësuesve apo metodës miks sipas nevojës.

Pengesat që ndërmarrjet furnizuese hasin janë të ndryshme, ndër kryesoret janë në lidhje me çmimet, kohën e dërgesës, transportit si dhe kornizat institucionale, të përcjellura nga standardet dhe cilësinë e kërkuar të lëndës së parë. Për më shumë detaje mund t'i referoheni figurës me poshtë.


Figura 3.1. Pengesat për ndërmarrjet furnizuese



Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Në kontrast, për nga perspektiva e furnizueseve në lidhje me pengesat e ndërmarrjeve importuese është më të theksuar madhësia e porosisë, që vlerësohet të jetë një pengesë e nivelit mesatar. Kurse pengesat tjera janë të ngjashme.

Figura 3.2. Pengesat për ndërmarrjet importuese




Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Analiza e Zingjirit të Vlerës – Prodhuesit

Krahas studimit për Zingjirin e Vlerës, nga numri i përgjithshëm i intervistave të realizuara 72% (65 NVM) prej tyre janë ndërmarrje prodhuese, ndërsa bazuar në aktivitetin të cilin ushtrojnë këto ndërmarrje janë të ndara në katër sektorë kryesor të prodhimit. Nga figura e mëposhtme kuptojmë se 81% e të anketuarve bëjnë prodhimin e veshjeve/rrobave të ndryshme, 11%, bëjnë prodhimin e mbathjeve 4% e të anketuarve bëjnë prodhimin e tekstilit shtëpiak, ndërsa 3% e ndërmarrjeve të anketuara bëjnë prodhimin e produkteve sipas kërkesës. Si pasojë e pandemisë Covid-19 dhe kërkesës së madhe për maska të fytyrës, këto ndërmarrje u janë adaptuar kërkesës së tregut.

Figura 3.3. Sektorët e ndërmarrjeve prodhuese



Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Sa i përket të punësuarve në këto ndërmarrje, numri më i lartë i të punësuarve është në sektorin e prodhimit duke u parë si veprimtaria kyçe e ndërmarrjes. Pjesa tjetër janë të punësuar në sektorin e shitjes dhe administrimit mirëpo që numri i tyre në krahasim me sektorin e prodhimit është shumë i ulët. Në këto ndërmarrje në mesin e të punësuarve në përgjithësi dominon gjinia femërore, e moshës mesatare prej 26-45 vjeç, ndërsa sa i përket shkollimit pjesa më e madhe e të punësuarve kanë të përfunduar shkollimin e mesëm.


Studimi nxjerr të dhënat lidhur me pagën mesatare bruto të stafit në sektorin e prodhimit, administratës dhe shitjes. Nga përgjigjet e pranuar është kuptuar se në 46% të ndërmarrjeve pjesëmarrëse, paga mesatare e punëtorëve në prodhim varion nga 170-240 euro, 32% të ndërmarrjeve kanë deklaruar se paga mesatare e stafit në sektorin e prodhimit është 250-340 euro, 17% deklarojnë se paga e punëtorëve arrin 350-440 euro, ndërsa pjesa e mbetur prej 5% të ndërmarrjeve deklarojnë se paga mesatare e tyre arrin deri në 640 euro bruto varësisht nga performanca e punëtorit.

Në sektorin e administratës, 59% e ndërmarrjeve paguajnë stafin me 170-240 euro, 27% prej tyre paguajnë me 250-340 euro, 12% e ndërmarrjeve paguajnë me 350-440 euro ndërsa pjesa tjetër prej 2% arrin pagën mesatare bruto deri në 540 euro.

Të dhëna thuajse të njëjta me sektorin e administratës janë dhënë edhe për punëtorët e sektorëve të shitjes, prej të cilave 55% e ndërmarrjeve paguajnë me 170-240 euro bruto, 28% e ndërmarrjeve

paguajnë me 250-340 euro bruto, 15% e ndërmarrjeve paguajnë stafin e tyre me 350-440 euro bruto, si dhe 2% paguajnë stafin e tyre me 450-540 euro bruto pagë mesatare.


Figura 3.4. Paga sipas sektorëve.



Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Vlen të theksohet se sfidë jashtëzakonisht e theksuar e këtyre ndërmarrjeve është gjetja e stafit të kualifikuar. Nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve prodhuese (65 NVM) 60% prej tyre kanë treguar se kanë shumë vështirësi në gjetjen e stafit të kualifikuar për punë, ndërsa 37% prej tyre kanë treguar se kanë pak vështirësi në gjetjen e punëtorëve të kualifikuar, dhe pjesa tjetër prej 2% tregojnë se nuk kanë aspak vështirësi për gjetjen e stafit të kualifikuar për punë.

Figura 3.5. Kuadrot profesionale




Në përgjithësi ndërmarrjet prodhuese kanë theksuar se në këtë veprimtari, stafi i sektorëve të prodhimit është mjaft i pa kualifikuar. Këto ndërmarrje mundësojnë ndjekjen e trajnimeve të cilat i organizojnë në ekipin e tyre për aftësimin e nevojshëm në përdorim të makinerive dhe proceset e prodhimit, mirëpo përkundër gjithë përpjekjeve mungon interesimi i duhur i të rinjve për punësim në këtë sektor.

Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve


Kuadro profesionale të cilat janë të nevojshme dhe të kërkuara në këtë sektor janë kryesisht në procesin e prodhimit ku 59% të ndërmarrjeve (kanë konfirmuar nevojën për staf të kualifikuar/me përvojë), kurse 26% të ndërmarrjeve kanë theksuar nevojën për kuadrot në sektorin e shitjes dhe 14% në atë të administratës. Nga ana tjetër kuadrot profesionale të cilat nuk i kemi në dispozicion në

vendin tonë, ndër më të theksuarat janë inovacioni me 35%, e përcjellur nga sektori i hulumtimit dhe zhvillimi me 21%, tjerat janë prodhimi, dizajni dhe shitja.

Figura. 3.6. Kuadrot profesionale të kërkuara



Kuadrot profesionale që nuk janë në dispozicion




Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Duke pas parasysh kuadrot profesionale të nevojshme dhe rritjen e efikasitetit në rrjedhën e punës, kërkesa për ngritjen e kapaciteteve në këto fusha është e domosdoshme. Gjithashtu, sipas të dhënave ndërmarrjet kanë theksuar nevojën për trajnimet në fushat e inovacionit dhe marketingut me nga 23%, tutje trajnimet për prodhim me 17%, pastaj trajnimet për rrjetëzim dhe tregje të reja të cilat përfaqësohen me 15% të përgjigjeve.

Tregjet vendore dhe ato eksportuese – Perspektiva e prodhueseve

Të dhënat lidhur me sasinë e prodhuar nga këto ndërmarrje për tregun vendor dhe eksport janë krahasuar për vitet, 2019 dhe 2020. Nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të cilat bëjnë eksport të produkteve jo të gjitha kanë deklaruar sasinë të cilën kanë prodhuar. Nga këto të dhëna kuptojmë se përkundër pandemisë viti 2020 ka pasur rritje në sasinë e prodhuar për eksport.


Figura 3.7. Sasia e prodhuar për eksport.



Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Ndërsa sa i përket sasisë së prodhuar për tregun vendor, është vërejtur rënie e lehtë e sasisë së prodhimit krahasuar me vitin 2019 dhe 2020. Gjë e cila ka ndodhur si pasojë e pandemisë Covid-19 dhe pezullimit të përkohshëm të thujasë të gjitha aktiviteteve të punës përfshirë ndërmarrjet prodhuese të Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës.

Figura 3.8. Sasia e prodhuar për treg vendor.




Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Norma e shfrytëzimit të kapaciteteve të ndërmarrjeve ndryshon në mënyrë të konsiderueshme njëra nga tjetra. Më shumë se gjysma e ndërmarrjeve prodhuese (34 NVM) 52% të intervistuar kanë theksuar se shfrytëzojnë deri në 50% të kapacitetit të përgjithshëm, e përcjellur nga 15% (10 NVM) prej tyre shfrytëzojnë 40% të kapaciteteve, gjithashtu (10 NVM) prej tyre shfrytëzojnë 60% të kapacitetit. Ndërmarrjet tjera shfrytëzojnë kapacitet në nivel më të lartë, por që numri i ndërmarrjeve bie drastikisht krahas rritjes së shkallës së përqindjes të shfrytëzimit të kapaciteteve.

Duke pas parasysh se pjesa më e madhe e ndërmarrjeve prodhuese nuk shfrytëzojnë kapacitetet e tyre të plota, të njëjtit treguan arsyet e shfrytëzimit të ulët të kapaciteteve të tyre. Siç është paraqitur në figurën e mëposhtme si shkaktarë kryesor që kanë ndikuar në mos shfrytëzimin e kapaciteteve janë konsideruar: (pa) mundësitë e tregut me 36%, konkurrenca me 27% dhe pandemia me 23%. Arsye të tjera ishin mungesa e punëtorëve me 6% dhe mungesa e njohurive të tregut me 4% e përgjigjeve etj.

Figura 3.9. Pengesat në shfrytëzimin e kapaciteteve



Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve


Ndër produktet kryesore të ndërmarrjeve prodhuese të sektorit për veshje/rroba pjesëmarrëse në këtë hulumtim janë: veshje të përditshme, veshje sportive, fustane elegante, lloje të ndryshme të uniformave të punës etj. Tek sektori i ndërmarrjeve prodhuese të mbathjeve, produktet kryesore të prodhuara janë; mbathje të përditshme, mbathje elegante, mbathje sportive për të rritur dhe fëmijë. Ndërsa tek sektori i ndërmarrjeve prodhuese të tekstilit, ndër produktet kryesore të prodhuara janë: lloje të ndryshme të çarçafëve dhe mbulesave për shtretër.

Pengesat në prodhim dhe eksport

Siç shihet në figurën e mëposhtme, ndër pengesat më të theksuara të ndërmarrjeve prodhuese kur ata synojnë prodhim cilësor, ofrimin e çmimeve të ulëta si dhe ngritjen e eksportit, janë: ndikimi i pandemisë me 35% të ndërmarrjeve, e ndjekur me koston e nevojshme për prodhim dhe cilësi me 22%, të ndërmarrjeve, si dhe konkurrenca me 14% të ndërmarrjeve.

Njëkohësisht janë përmendur edhe shërbimet e marketingut, procesi i prodhimit, legjislacioni, mungesa e fuqisë punëtore, dhe investimet e nevojshme në makineri. Numri më i madh i sfidave kategorizohen si kufizime interne apo organizative që vjen si pasojë e limitimeve ndërmarrëse, kurse si faktorë i jashtëm është sfida globale me situatën pandemike, situatë kjo sipas të cilës duhet të adaptohet rrjedha e punës. Në baza vjetore Qeveria e Kosovës mbështet bizneset e ndryshme përmes skemave dhe granteve, gjithashtu sektori i financave ndër vite është bërë më i favorshëm në lidhje me normat e interesit për kreditë tregtare.

Figura 3.10. Pengesat për prodhim



Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Qeveria e Kosovës me qëllim të rritjes së qasjes në financa për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në Kosovë, dhe me qëllim të krijimit të vendeve të punës, rritjen e prodhimit vendor, shërbimet me vlerë të shtuar, përmirësimit të bilancit tregtar dhe zgjerimin e mundësive të financimit për ndërmarrje ka ndihmuar në themelimin e Fondit për Garantimin e kredive, i cili mbulon 50% të rrezikshmërisë potenciale për kreditë përkatëse të lëshuara nga bankat komerciale, dhe njëkohësisht ndërmarrjeve private ju mundëson qasje më të lirë në financa.

Qarkullimi i industrisë së prodhimit të Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës

Bazuar në të dhënat e pranuar nga ndërmarrjet pjesëmarrëse të këtij studimi, vlera mesatare e qarkullimit për tregun vendor në vitin 2019 për ndërmarrje arrinte 43.427 euro ndërsa viti 2020 shënon vlerën mesatare të qarkullimit për ndërmarrje 23.997 euro. Njëkohësisht janë pranuar dhe të dhënat në lidhje me qarkullimin vjetor për eksport, ku vërejmë se vlera mesatare e qarkullimit vjetor për ndërmarrje në vitin 2019 arrin në 77.704 euro ndërsa viti 2020 shënon vlerën mesatare të qarkullimit për ndërmarrje 101.508 euro. Nga kjo kuptojmë se sektori i Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës synim kryesor për vitin 2020 ka pasur tregun e jashtëm.

Vlera mesatare e qarkullimit vjetor e ndërmarrjeve të intervistuar	Viti 2019	Viti 2020
Tregu vendor	43,427.07 €	23,997.94 €
Eksport	77,704.50 €	101,508.07 €
Totali	121,131.57 €	125,506.02 €

Tabela. 3.3. Vlera e qarkullimit për vitin 2019 dhe 2020 sipas të dhënave.

Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Të njëjtin trend mund ta vërejmë edhe në të dhënat zyrtare të Agjencisë të Statistikave të Kosovës, ku vërehet rënie në qarkullimin mesatar vjetor për tregun vendor, ndërsa një rritje të qarkullimit mesatar vjetor për eksport.

Vlera mesatare e qarkullimit vjetor	Viti 2019	Viti 2020
Tregu vendor	16,804.820 €	7,961,048 €
Eksport	14,249,750€	25,440,788 €
Totali	31,054,570 €	33,401,836 €


Tabela. 3.4. Vlera e qarkullimit për vitin 2019 dhe 2020 sipas të dhënave zyrtare ASK.

Burimi: ASK dhe MINT


Inovacioni

Në 36 muajt e fundit 82% (53 NVM) nuk kanë investuar në kërkime, zhvillime apo aktivitete të lidhura me inovacionin për prodhimin e produkteve të reja ose linjave të prodhimit, ndërsa pjesa tjetër e ndërmarrjeve, 18% (12 NVM) kanë pohuar se kanë investuar në kërkime, zhvillime apo aktivitete të lidhura me inovacionin të cilat kanë ndihmuar direkt në ndërmarrjet që të prezantojnë linja apo produkte të reja në treg. Nga ndërmarrjet të cilat kanë investuar në kërkime, zhvillime apo aktivitete të lidhura me inovacionin, 55% kanë përdorur 3% të qarkullimit vjetor në hulumtim dhe zhvillim, 27% e të anketuarve kanë investuar 5%, dhe 9% kanë investuar më shumë se 10% të qarkullimit vjetor në hulumtim dhe zhvillim të ndërmarrjes. Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve kanë bërë prezantimin e produkteve të reja në takimet me bizneset të cilat bashkëpunojnë dhe përmes rrjeteve sociale.

Grafi 3.11. Investimet lidhur me inovacionin



Grafi 3.12 % e qarkullimit vjetor investuar në inovacion




Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Nga 27% e ndërmarrjeve, produktet që janë prezantuar, konsiderohen të reja për tregun ku vepron ndërmarrja, që do të thotë se këto produkte nuk kanë ekzistuar më parë në tregun vendor. Ndërsa 73% e ndërmarrjeve njoftojnë se produktet e prezantuara janë të reja për ndërmarrjen por të cilat kanë qenë prezente edhe më herët në treg.

Të gjitha ndërmarrjet të cilat kanë shtuar produkte apo shërbime të reja, kanë njoftuar se kërkimet, zhvillimet dhe aktivitetet e lidhura me inovacionin janë bërë vetëm nga ndërmarrjet dhe nuk ka pasur bashkëpunim me ndonjë partner të jashtëm.

Figura 3.13. Produktet e prezantuara



Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Nga ana tjetër, bashkëpunimi në mes ndërmarrjeve paraqet një motiv shpresëdhënës, duke marrë parasysh që të dhënat tregojnë një bashkëpunim të ndërsjellët. Përqindja më e madhe e ndërmarrjeve që deklarojnë bashkëpunim të ndërsjellët është ajo me ndërmarrjet e vogla, gjegjësisht 39%, ndërsa 38% bashkëpunojnë me ndërmarrjet mikro. Bashkëpunimi me ndërmarrje të mëdha rezulton në 7%, kurse ajo me ndërmarrje të mesme është 13%.


Transporti

Ky hulumtim përmban të dhëna në lidhje me transportin nga perspektiva e ndërmarrjeve transportuese, që janë gjithsej 6% e mostrës totale, ndërmarrjet prodhuese që përbëjnë pjesën dërmuese të mostrës me 72%, dhe ndërmarrjet furnizuese me 12%, të dhëna të cilat janë shfrytëzuar për analizën e këtij seksioni.

Për këtë analizë nga mostra e përzgjedhur, 6% (5 NVM) prej tyre ofrojnë shërbime të transportit të produkteve të Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës. Të dhënat demonstrojnë forma të ndryshme të organizimit të transportit të mallrave, siç janë ato ndërmarrje të cilat organizojnë transportin plotësisht në baza vetanake, ato të cilat kanë bashkëpunim me ndonjë ndërmjetësues dhe ato ndërmarrje të cilat i shfrytëzojnë dy llojet e aranzhimeve të transportit.

Ndërmarrjet prodhuese të intervistuar, 53% (34 NVM) kanë deklaruar se transportin e organizojnë në baza vetanake, 5% (3 NVM) kanë njoftuar se punojnë vetëm me ndërmjetësues për aranzhime transporti dhe 42% (27 NVM) kanë deklaruar se përdorin të dy metodat për transport varësisht nga nevoja. Nga ana tjetër, rreth 18% (12 NVM) e ndërmarrjeve kanë njoftuar se bashkëpunojnë vetëm me një ndërmarrje transportuese, 34% (22 NVM) kanë thënë se bashkëpunimi i tyre është me 2 deri në 5 ndërmarrje transporti dhe pjesa tjetër prej 48% (31 NVM) kanë deklaruar se procesin e transportit e kryejnë plotësisht në baza vetanake.

Figura 3.14. Kriteret e përzgjedhjes së ndërmarrjeve transportuese



Ndër kriteret më të rëndësishme se si këto ndërmarrje vendosin për përzgjedhjen e ndërmarrjeve të transportit janë: besueshmëria, kosto e transportit, koha e furnizimit, kualiteti dhe transparenca.


Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Për të kuptuar kostot që lidhen me transportin, gjetjet nga intervistimi me ndërmarrjet përkatëse kanë treguar se kostoja mesatare e transportit në vendet evropiane varion nga 1500 deri në 2000 euro për 20 tonë. Kjo lëvizje ndërmjet çmimeve arsyetohet me distancë të ndryshme midis vendeve evropiane. Nga ana tjetër, kemi dhe koston mesatare të transportit për vendet rajonale e cila varion nga 30 deri në 45 euro për ton.

Kostoja mesatare e transportit në koston e përgjithshme të produkteve llogaritet deri në 9% e qarkullimit për 82% të ndërmarrjeve të intervistuar, kurse deri në 19% e qarkullimit për 18% të ndërmarrjeve të intervistuar.

Ndër sfidat me të cilat ndërmarrjet ballafaqohen gjatë eksportit të mallrave janë, procedurat e eksportit që rezultuan me 44% nga gjithsej përgjigjet e pranuar. Si barrierë sekondare më e përmendur është kosto e transportit e cila përfaqëson 32% të sfidave nga përgjigjet e këtyre ndërmarrjeve dhe pjesa tjetër prej 24% kanë deklaruar si sfida kryesore ofrues të limituar që kanë specializim në këtë fushë.

Figura 3.15. Barrierat në eksport



Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Tregjet e eksportit dhe kërkesat për eksport

Studimi paraqet analizën e eksportit nga perspektiva e ndërmarrjeve prodhuese të tregut vendor. Nga numri i përgjithshëm i të intervistuarve pjesëmarrës në këtë hulumtim është kuptuar se 14% e ndërmarrjeve janë të përfshira në aktivitetet biznesore në tregun e jashtëm dhe aktualisht eksportojnë në vendet tjera, me fokus në vendet e Evropiane. Ndërsa 86% prej tyre deri më tani nuk janë duke eksportuar produktet e tyre, megjithëse një pjesë e tyre pretendojnë që në të ardhmen e afërt të zgjerojnë aktivitetet e tyre edhe jashtë vendit. Për realizimin e eksportit të produkteve të tyre disa nga dokumentet e nevojshme të cilat kërkohen të plotësohen janë:

- Origjina e mallit;
- Emri dhe klasa e mallrave;
- Lloji i mallrave;
- Vërtetimi për cilësinë, ISO – standardet;
- Raporti për deklarata mbi produktin e importuar/eksportuar të lëshuar nga Inspektorati shtetëror i tregut;
- Pesha bruto (kg);
- Vlera e mallrave
- Mallrat e paketuara ose të pa paketuara.


Ndërsa disa nga certifikatat të përmendura nga ndërmarrjet e intervistuar të cilat kërkohen për eksport janë:

- ISO 9001:2015 (specifikon kërkesat e sistemit të menaxhimit të cilësisë)
- Certifikate e BSCI (BSCI është sistemi evropian i monitorimit social për burimet etike i iniciuar nga Shoqata e Tregtisë së Jashtme me bazë në Bruksel (MTL);

- Certificate e JCS (është një nga organet kryesore të certifikimit të palëve të treta që merret në fushën e certifikimit të sistemit të menaxhimit);
- Certifikata Stema;

Identifikimi i klientëve të rinj dhe/apo zgjerimi në tregjet të reja, është një proces jashtëzakonisht i rëndësishëm për suksesin e një ndërmarrje. Prandaj, ndërmarrjet konsiderojnë hulumtimin e tregut si një nga mënyrat më të suksesshme për të arritur objektivat në identifikimin e klientëve të rinj apo edhe zgjerimin e tregut. E ndjekur nga hulumtimet në internet, një formë mjaft e përdorshme nga ndërmarrësit e këtij sektori. Panairët tregtare vlerësohen si mjet i tretë më i përdorur për të gjetur klientë dhe tregje të reja ndërsa pjesa tjetër kanë deklaruar se i përdorin lidhjet familjare dhe personale në diasporë si dhe klientët e mundshëm nga vendet e eksportit me të cilët kanë kontakt për të ndërtuar rrugë lidhje të reja.

Figura 3.16. Identifikimi i klientëve



Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Ndërmarrjet e intervistuar eksportojnë kryesisht në Itali, Maqedoninë e Veriut, Zvicër, Shqipëri, Gjermani, Suedi dhe më pak në vendet e tjera si në Slloveni, Arabi Saudite, Izrael, Dubai etj. Sipas sektorëve, siç shihet në tabelën më poshtë (3.4), veshjet/rrobat përkatëse kryesisht eksportohen në Shqipëri, Zvicër pastaj në Gjermani, Holandë, Maqedoninë e Veriut dhe në Mal të zi. Ndër arsyt kryesore që eksportet janë të orientuara në nivel rajonal, janë të ndërlidhura drejtpërdrejt me vlerën e kostove të transportit, si dhe standardet e kërkuara në këto vende, disa prej tyre siç janë: ISO 9001: 2015, përmbajtja dhe origjina e mallit etj.

Nga sektori i produkteve prej lëkurës, ato eksportohen kryesisht në Francë dhe në Itali. Ndër përparësitë kryesore konkurruese të këtij sektori nga të gjeturat në hulumtim është cilësia e produktit por që njëkohësisht përcjellët me një avantazh më atraktiv e cila është kosto e ulët dhe taksa në të ardhura të ulëta. Ndër standardet kryesore të kërkuara janë: ISO, BSCI, JCS dhe STEMA.


Tabela 3. 4. Eksporti sipas sektorëve, produkteve dhe vendeve të eksportuara

Sektori	Produktet e eksportuara	Vendet kryesore për eksport	Arsyeja e suksesit	Certifikatat
Veshje/rroba	Fustane, xhemperë, maska për fytyrë etj.	Zvicër, Shqipëri, Mali i Zi, Gjermani, Maqedoni e Veriut dhe Holandë	Produkt cilësor dhe çmimi	ISO 9001
Produktet nga lëkura	Këpucë	Franca dhe Itali	Kualitet, çmimi dhe profesionalizmi	ISO, BSCI, JCS, STEMA

Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Parashikimi i ndërmarrjeve për vijueshmërinë e eksportit në vitin 2021 dhe 2022 është pritshmëri pozitive në rritje të eksportit në sektorët e lartë theksuar. Në vitin 2021 është parashikuar rritje mesatare 25% e eksportit nga 85% e të intervistuarave, ndërsa 15% nuk presin të ketë ndryshime në këtë aspekt. Në vitin 2022, 90% e ndërmarrjeve kanë shprehur optimizëm se presin të kenë rritje mesatarisht 40%, në eksport, ndërsa 10% nuk presin të ketë ndryshime në rrjedhën e eksportit.


Figura 3.17. Parashikimi i eksportit për 2021 dhe 2022



Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Ndër motivet kryesore që i shtyn ndërmarrjet vendore të synojnë tregjet e huaja (eksportin) janë çasja në tregje më të gjera me (45%) të ndërmarrjeve, që rezulton gati gjysmën e të anketuarve. Çmime (marzha) më të favorshme (44%), si dhe diversifikimi i tregut me (11%). Përparësitë kryesore të perceptuara konkurruese të këtyre ndërmarrjeve janë kualiteti i produkteve të prodhuara me 62%, dhe çmimi me 38%.

Figura 3.18. Arsyet e shitjes në tregjet e jashtme



Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Ambienti biznesor

Korniza ligjore që ndikon në sektorët e Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës rregullohet nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, dhe Ministria e Financave dhe Transfereve sipas të cilave operojnë edhe Administrata Tatimore e Kosovës dhe Doganat e Kosovës.

Figura 3.19. Kornizat ligjore dhe mundësi i mjedisit



Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë është përgjegjëse për zhvillimin e politikave të lidhura me sektorin industrial, nxitjen e rritjes së sektorëve privat, me fokus në NVM dhe promovimin e politikave që përmirësojnë mjedisin e biznesit.

Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është institucioni përgjegjës për çështjet mjedisore. Duke marrë parasysh presionin shoqëror dhe atë institucional, njëkohësisht edhe vetëdijesimin social në përgjithësi, zhvillimi i praktikave biznesore duhet të adaptohet me kërkesat aktuale në lidhje me mbrojtjen e mjedisit. Sektorët e Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës, kanë një rol të rëndësishëm për të luajtur në përmirësimin e ndotjes së përgjithshme të ambientit.

Ministria e Financave dhe Transfereve, dhe Administrata Tatimore e Kosovës janë institucionet ligjore përgjegjëse për politikat dhe taksat fiskale. Është e rëndësishme të përmendet se politika fiskale në Kosovë bazohet në praktikat e mira të BE-së. Dogana e Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e rregulloreve doganore, veçanërisht për mbledhjen e detyrimeve doganore, si dhe përshkrimin e tregtisë dhe mbrojtjes së markave tregtare dhe të tjerave. Meqenëse Kosova vepron sipas marrëveshjeve CEFTA-së dhe integritit aspirues në BE, Dogana e Kosovës vepron në përputhje me standardet e BE.

Rrjetëzimi (Perspektiva e ndërmarrjeve)


Bashkëpunimi me shoqata/institucione të ndryshme ju lejon ndërmarrjeve të ndër-veprojnë me njerëz që ndajnë ide të ngjashme, të cilët mund të jenë burime informacioni dhe mbështetjeje – që rezultojnë në ngritjen e klientëve të ndërmarrjes. Anëtarësimi i ndërmarrjeve në shoqata është një mënyrë e shkëlqyer për të kontribuar në rritjen e sektorëve në përgjithësi dhe të ndërmarrjes në veçanti.

Nga ndërmarrjet e intervistuar në sektorët e Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës, vetëm 11% e ndërmarrjeve janë të anëtarësuara në organizatat si: KAMA, Oda Ekonomike të Kosovës dhe Oda e Afarizmit të Kosovës.

Shoqata Kosovare për Marketing të Veshmbathjeve (SHKMV) - KAMA është një organizatë e përqendruar në sektorin e veshmbathjeve, që promovon rrjetëzimin ndërmjet bizneseve vendore dhe ndërkombëtare në sektorin e veshmbathjeve. Aktivitetet e KAMA-së synojnë ta lehtësojnë këmbimin e njohurive profesionale dhe të përvojës. Vizioni i tyre është që të drejtojë përpjekjet e akterëve të industrisë së veshmbathjeve në Kosovë që ata të zënë vend në hartën e tregut evropian dhe më gjerë. Oda Ekonomike e Kosovës kontribuon në zhvillimin e ndërmarrjeve, po ashtu me profesionalizmin dhe vendosmërinë e saj kontribuon në përafrimin e biznesit kosovar dhe shoqërisë kosovare me vlerat evropiane. Oda e Afarizmit të Kosovës - OAK është organizatë e biznesit e cila financohet përmes anëtarësisë, shërbimeve, ngjarjeve dhe projekteve të veçanta. OAK veprimtarinë e saj e ka të përqendruar në katër shtylla kryesore të cilat përfshijnë: avokim, zhvillim, shërbime biznesore dhe rrjetëzim. Një nga shërbimet kryesore që OAK ofron për bizneset është rrjetëzimi dhe lobimi në tejkalimin e barrierave të hasura gjatë bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar. Për ta arritur këtë, oda ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi edhe me odat nga rajoni.

Lidhur me vlerat e shtuara duke qenë anëtarë të këtyre organizatave/ shoqatave së bizneseve, ndërlidhja me partner relevant është ndër shërbimet të cilat ndihmojnë ndërmarrjen e tyre për të shtuar intensitetin e punës e cila përfaqëson 26% të përgjigjeve. Ndjekur nga mbrojtja e interesave të sektorit me 21%, ngritjen e kapaciteteve të ndërmarrjes me 16%, njohjen me trendet dhe kërkesat e sektorit me 16%, fuqizimin e sektorit me 16%, si dhe informacioni për panaire e cila përfaqëson 5% e përgjigjeve në lidhje me vlerat e shtuara nga të qenurit anëtarë i Organizatave/Shoqatave.

Figura 3.19. Vlerat e shtuara si anëtarë i Organizatave/Shoqatave



Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Sistemi arsimor i Kosovës ofron programe të ndryshme në shtatë universitete publike, mbi 80 shkolla profesionale dhe trajnuese dhe dhjetëra ofrues të arsimit privat, si në arsimin e mesëm dhe të lartë. Në këto shkolla profesionale janë edhe klasat e Tekstilit që posedojnë të gjitha elementet e nevojshme duke filluar nga makinat e qepjes, materialet e palosura deri në detajet e nevojshme.

Përkundër mundësive të ofruara nga shkollat profesionale për aftësimin në zanatin e rrobaqepësisë, duhet të theksohet se mungon interesimi i gjeneratave të reja në ndjekjen e tyre. Bashkëpunimi i ndërmarrjeve me akterët/partnerët të cilët ofrojnë ekspertizë profesionale dhe shërbime mbështetëse përkatëse (universitetet, institutet kërkimore/laboratorë, kompanitë konsulente etj), përfshinë 14% e të intervistuarve, që shfrytëzohen si partner për ekspertizën e tregut dhe që vijnë kryesisht nga Kosova, ndërsa 86% kanë njoftuar se nuk kanë bashkëpunim të tillë me ndonjërin nga akterët apo partnerët e tyre.


Mbështetja e sektorëve të Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës nga akterët relevant

Qëllimi dhe prioriteti kryesor i shoqatave/institucioneve është që të avokojë nevojat e sektorëve drejt hartuesve të politikave, me qëllim që të ndikojë përfshirjen e sektorit të Tekstilit si një nga sektorët me prioritet në Kosovë.

Të gjeturat e këtij hulumtimi janë bazuar në të dhënat e pranuar nga realizimi i intervistave me përfaqësuesit e institucioneve/organizatave, prej të cilave kemi kuptuar se 78% e të anketuarve kanë përkrahur sektorët e Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës, ndërsa 22% mohuan se kishin përkrahur ndonjëherë këta sektorë.

Disa nga format e mbështetjes të këtyre sektorëve të cilat janë përmendur nga të intervistuarit janë: aftësimi profesional e cila ka intensitetin më të lartë të raportimit nga institucionet/organizatat e ndjekur nga mbështetja financiare, shërbimet për avokim dhe lobim, hartim të strategjive dhe zhvillim të politikave.

Figura 3.20. Format e mbështetjes për sektorë e Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës



Burimi: Të dhëna nga hulumtimi, kalkulimi i autorëve

Disa nga projektet të cilat janë mbështetur nga institucionet/organizatat e intervistuar janë:

- Programet e masave aktive të tregut të punës;
- Aftësim profesional në vendin e punës; si dhe
- Mentorim dhe trajnime të ndryshme.

Për sa i përket planeve të së ardhmes se a do jenë të përfshira projekte të cilat përkrahin këtë sektor, 62% e të intervistuarve kanë pohuar se në planet e tyre përfshihet edhe mbështetja e sektorëve të Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës, ndërsa 38% kanë mohuar të kenë diçka konkrete në planet e tyre për sa i përket këtij aspekti. Këto shoqata/institucione janë pyetur dhe për, se sa nga anëtarët e regjistruar i përkasin sektorëve të Tekstilit Veshjes dhe Lëkurës, me më pak se 40% është përgjigjur pjesa më e madhe e tyre duke përfaqësuar 75% nga përgjigjet dhe me 50% të anëtarëve të regjistruar nga ky sektorë janë përgjigjur 25% nga institucionet/organizatat.

RASTE STUDIUM – NDËRMARRJA A DHE NDËRMARRJA B

STUDIMI I RASTIT 1: NDËRMARRJA A

Ndërmarrja pjesëmarrëse si rast studimi në këtë hulumtim, është themeluar në vitin 1992, e njëjta për 4 vitet vijuese si aktivitet kryesor ka pasur vetëm tregtinë e mallrave, ndërsa nga viti 1996 ka filluar prodhimin e llojeve të ndryshme të këpucëve.

Fillimisht fokus kryesor i saj ishte shitja me pakicë në tregun vendor, mirëpo pas një suksesi të arritur ka filluar zgjerimin e shërbimeve të saj për eksport dhe shitjen B2B.

E njëjta ka filluar shitjen me shumicë që nga viti 2002, dhe ashtu si në tregun vendor dhe në atë të jashtëm produktet e tij ekspozohen për shitje në ndërmarrjet më të mëdha.

Investimi i pandalshëm në makineritë e fundit në treg, i ka mundësuar që procesi i prodhimit të kryhet me precizitet të lartë. Si rezultat i kësaj në vazhdimësi kjo ndërmarrje deri më tani ka prodhuar mbi 2000 modele të këpucëve për shitje, dhe njëkohësisht ka lidhur marrëveshje me ndërmarrje të jashtme për procesin e prodhimit, me disa prej tyre për 49% të procesit të prodhimit të këpucëve ndërsa me disa ndërmarrje të tjera ka filluar prodhimin e produkteve finale të këpucëve sipas marrëveshjes.

Kjo ndërmarrje numëron afro 249 punëtorë, ku 80% prej tyre janë punëtorë në sektorin e prodhimit, 12% prej tyre punojnë në sektorin e shitjes dhe pjesa tjetër prej 8% punojnë në sektorin e administratës.

Përveç investimit ndër vite në makineritë e shfrytëzuara, e njëjta vazhdon investimin e saj dhe në stafin e angazhuar në sektorin e prodhimit, të cilëve në vazhdimësi ju ofron trajnime lidhur me procesin e prodhimit, përdorimin e makinerive të reja, efikasitetin në punë si dhe shumë fusha të tjera përmes të cilat kontribuojnë në sasinë dhe kualitetin e prodhuar.

Rrugëtimi i ndërmarrjes ndër vite, përveç suksesit të arritur deri më tani ka shfaqur dhe sfida të njëpasnjëshme, ndër to vlen të theksohet mungesa e interesimit të fuqisë punëtore për punë fabrikë përkundër kushteve të cilat i ofrohen.

STUDIMI I RASTIT 2: NDËRMARRJA B

Kjo ndërmarrje është themeluar në vitin 2016, mirëpo zyrtarisht punën e ka filluar nga muaji maj i vitit 2017.

Ndërmarrja prodhon veshje të ndryshme për klientët në përputhje me pritshmëritë e tyre për kohën, cilësinë dhe sasinë, duke përdorur burime të furnizimit në nivel vendor dhe global. Në përputhje me pritjet e tregut, ekipi i dizajnit jo vetëm që mbështet klientët me ide të reja mbi fijen, zbukurimet dhe detajet e qepjes, por gjithashtu krijon koleksione katalogësh për një kohë të caktuar në mënyrë që ti mbajë klientët në hap me trendin.

Në ndërmarrjen në fjalë një njësi e tërë e zhvillimit të produktit i kushtohet zhvillimit të stileve të reja. Ka teknologji të kompjuterizuar plotësisht dhe një ekip komunikues të talentuar. Dhoma e mostrës ka kapacitetin për të prodhuar 4 modele dhe 12 mostra në ditë. Kapaciteti total i prodhimit mujor (thurje, qepje dhe përfundim) është rreth 10.000 copë.

Ndërmarrja planifikon, organizon dhe prodhon në mënyrën më efektive. Produktiviteti i operatorëve në njësinë prodhuese matet në baza të rregullta. Kjo ndërmarrje vazhdimisht zhvillon dhe kryen projekte për uljen e kostos për të qenë në gjendje të japë çmimet më konkurruese dhe të sigurojë kënaqësinë më të lartë të klientit. Linjat e thurjes së fabrikave kombinojnë aftësitë njerëzore të kualifikuara me një sistem të zhvilluar dhe me teknologji të përparuar.

Ndërmarrja ka investuar shumë në teknologji dhe automatizim për të arritur produktivitetin maksimal në prodhimin e veshjeve të trikotazhit.

Kjo ndërmarrje numëron rreth 90 punëtorë, që e klasifikon atë si ndërmarrje e mesme. Sfidë kryesore e thekson mungesën e kualifikimit të fuqisë punëtore, por edhe luhatjet e punëtorëve të cilët nuk janë stabil për punë në sektorin e prodhimit.

Ndërmarrja në fjalë nuk punon me ndërmarrje vendore apo të tjera, ajo ka marrëveshje me vetëm një klient, dhe shprehë se ka mjaftueshëm qarkullim nga ndërmarrja në fjalë dhe nuk shpreh interesim për bashkëpunim me ndërmarrje të tjera.

KUFIZIMET KRYESORE TË SEKTORËVE

Ky studim gjithashtu shtjellon kufizimet kryesore të sektorëve të tekstilit, veshjeve dhe lëkurës. Mbase këto kufizime mund të shërbejnë si pikë nisje për tu thelluar tutje në shkaqet themelore si dhe propozimet e ndërhyrjeve adekuate.

Kufizimet e identifikuara përgjatë këtij studimi janë:

1. Burimet njerëzore dhe aftësimi profesional i të punësuarve në prodhim;
2. Qasja në treg dhe pengesat në procesin e eksportit;
3. Cilësia e operimeve biznesore;
4. Vështirësitë në furnizimit me lëndë të parë;
5. Mungesa e zonave industriale në të gjitha Komunat e Kosovës;
6. Pandemia Covid-19.

Burimet njerëzore dhe aftësimi profesional i të punësuarve në prodhim: Ky studim nxjerr në pah nevojën e domosdoshme për aftësim profesional të punëtorëve në veçanti atyre të angazhuar në proceset e prodhimit. Si fillim, sfidë mjaft e theksuar është paraqitur mungesa e interesimit të punëtorëve për t'u aftësuar dhe zhvilluar shkathhtësitë e tyre në procesin e prodhimit të produkteve të tekstilit, veshjes dhe lëkurës,

Së dyti duke i konsideruar sektorët e Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës, sektor me potencial për rritjen e numrit të punësuarve, mungojnë njohuritë, aftësitë dhe kualifikimet e punës të cilat nuk janë në përputhje me kërkesat e prodhuesit apo furnizuesit. Ndërmarrjet ankohen për mungesë të kuadrove të përgatitura, mungesë të personelit administrativ dhe menaxherial me përvojë si dhe ndërmarrjet hasin në mungesë të menaxherëve të specializuar. Programet e trajnimit të Arsimit dhe Aftësimit Profesional (AAP) shpesh janë më shumë të orientuara drejt furnizimit se sa drejt kërkesës, edhe pse qendrat rajonale të punësimit përpiqen të përmirësojnë bashkëpunimin me ndërmarrjet. Preferencat e punësimit shpesh janë anëtarët e familjes në vend të punësimit të bazuar në nevoja si dhe struktura standarde të pagave (pagë fikse), nuk ofrohen forma tjera të nxitëse të motivimit siç janë ato në bazë të performancës apo tjera.

Qasja në treg dhe pengesat në procesin e eksportit: Studimi i Zingjirit të Vlerës për sektorët e Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës paraqet interesimin e ndërmarrjeve për eksport në vendet e BE dhe vende të tjera, mirëpo përkundër kësaj hasin në kufizime të shumta të cilat e ngadalësojnë këtë proces. Ndër to, është mënyra e gjetjes së tregjeve të reja për eksport, pasi që thuajse të gjitha ndërmarrjet pjesëmarrëse në hulumtim kanë deklaruar se klientët apo tregjet e reja i identifikojnë përmes hulumtimit të tregut në baza vetanake, përmes hulumtimit në internet dhe panairove tregtare. Gjithashtu, ekzistojnë të dhënat e pamjaftueshme dhe jo të besueshme të tregut. Të dhënat e tregut dhe segmentet e klientëve nuk janë të njohura mjaftueshëm në vende të ndryshme të synuara të BE-së, duke rezultuar në strategji të paqarta të marketingut, produkteve dhe të komunikimit me klientë. Që rezulton në një segmentim dhe pozicionim reaktiv në tregje, dhe duke i shfrytëzuar lidhjet aktuale ose njoftësitë familjare. Për shkak të analizës dhe hulumtimit të dobët të tregut, potencialet e tij mbeten të pa shfrytëzuara.

Shumica e ndërmarrjeve kosovare të tekstilit nuk e kanë personelin e duhur të specializuar për përgatitjen apo mirëmbajtjen brenda ndërmarrjes të shërbimeve të ueb-it dhe marketingut të mediave të reja. Gjithashtu, nuk shfrytëzojnë mjaftueshëm kanalet e reja të komunikimit dhe shitjes.

Sektorët e Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës në Republikën e Kosovës kanë mjaft potencial për arritjen e marrëveshjeve me ndërmarrje të tjera nga vendet e BE, qoftë për procesin e prodhimit të produkteve të ndërmarrjes bashkëpunuese por dhe për ekspozimin e produkteve të prodhuara dhe dizajnuara nga ndërmarrja vendore. Vlen të theksohet se mungon mbështetja institucionale për pjesëmarrje në panaire rajonale apo ndërkombëtare të veçanta të këtij sektori dhe vizitat studimore. Paralelisht, sfidë mjaft e rëndësishme është plotësimi dhe përshtatja në përpikëri e kërkesave të eksportit, duke përfshirë cilësinë, sasinë dhe arritjen në kohë të prodhimit sipas porosisë.

Cilësia e operimeve biznesore: Duke marrë parasysh alokimin jo mirë të balancuar të investimeve, ka ngecje në aktivitete kyçe që ndikojnë në zhvillimin e bizneseve. Investimet në Hulumtim dhe Zhvillim të produkteve janë të pamjaftueshme, sidomos kur synohet zgjerimi i eksportit në tregje të reja, si dhe investime të ulëta në strategji të mirëfillta të marketingut, komunikimit dhe shitjes.

Është evidentuar mungesa e planifikimit strategjik të biznesit, ku shumica e ndërmarrjeve operojnë pa plan biznesi, përfshirë planin e marketingut dhe të eksportit. Ndërmarrjet nuk kanë vizion dhe objektiva të qarta dhe shpesh veprojnë në baza reaktive. Menaxhimi i inovacionit dhe priorizimi i masave të inovacionit nuk janë zhvilluar mjaftueshëm në të gjithë sektorët.

Kapacitetet e vogla të ndërmarrjeve kosovare limitojnë mundësitë për të përmbushur porosi më të mëdha të eksportit. Për shkak të kapaciteteve të ulëta prodhuese numri më i madh i ndërmarrjeve ka të kufizuar mundësinë e plotësimit të kërkesave të eksportit.

Mungesa e furnizimit me lëndë të parë: I gjithë procesi i prodhimit të ndërmarrjeve të këtyre sektorëve është i varur nga importi i lëndës së parë dhe materialeve të nevojshme për prodhim. Si rrjedhojë, jo rrallë herë ka vonesa, andaj ky fakt pezullon aktivitetin e prodhimit të ndërmarrjes në tërësi.

Në shumë raste ndërmarrjet lokale e shohin njëra tjetrën si konkurrencën kryesore e jo si partner potencial për përmirësim të mundësive për eksport.

Mungesa e zonave industriale në të gjitha Komunat e Kosovës: Një ndër sfidat e identifikuara nga ky studim është dhe mungesa e zonave industriale në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës. Duke marrë parasysh benefitet që sjell zona industriale, përfshirë ofrimin e hapësirës së nevojshme për prodhim, qira më të përballueshme dhe sigurimi i energjisë elektrike. Ky do ishte një investim jo vetëm për sektorin e tekstilit, veshjes dhe lëkurës, por për të gjithë sektorët tjerë relevant.

Pandemia Covid-19: Situata pandemike gjithashtu konsiderohet si kufizim i ndërmarrjeve të këtij sektori. Si pasojë e situatës së përkeqësuar me pandeminë Covid-19 viti paraprak ishte më pak

fitimprurës në përgjithësi. Përveç më pak fitimprurës, kjo situatë ka shkaktuar panikë dhe ka ndikuar në efikasitetin e punëtorëve.

REKOMANDIMET

Duke u bazuar në të dhënat e këtij studimit, janë identifikuar vështirësitë dhe kufizimet e sektorëve të Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës të cilat janë diskutuara më lartë. Gjithashtu, si pjesë integrale janë përfshirë edhe ndërhyrjet e rekomanduara për secilën nga vështirësitë e identifikuar, të cilat do ndikojnë drejtpërdrejt në avancimin e këtyre sektorëve.

VËSHIRËSITË	KUFIZIMET	NDËRHYRJET E REKOMADUARA
Burimet njerëzore dhe aftësi profesionali i të punësuarve në prodhim:	▪ Njohuritë, aftësitë dhe kualifikimet e punës nuk janë në përputhje me kërkesat e prodhuesit apo furnizuesit. Ndërmarrjet ankohen për mungesë të kuadrove të përgatitura. Kurrikulat e trajnimeve janë më shumë të orientuara drejt furnizimit se sa drejt kërkesës, edhe pse qendrat rajonale të punësimit përpigjen të përmirësojnë bashkëpunimin me ndërmarrjet. ▪ Mungesa e personelit administrativ dhe menaxherial me përvojë. Ndërmarrjet hasin në mungesë të menaxherëve të specializuar. Preferencat e punësimit shpesh janë anëtarë të familjes në vend të punësimit të bazuar në nevojë. ▪ Struktura standarde të pagave (pagë fikse), nuk ofrohen forma tjera nxitëse të motivimit siç janë ato në bazë të performancës apo tjera.	✓ Përveç trajnimeve teorike, instruktimi (coaching) është shtesë praktike e cila u mundëson të trajnuarve që t'i zbatojnë më mirë aftësitë e tyre të reja dhe të marrin më shumë pronësi në vendin e tyre të punës. ✓ Vlerësimi i rregullt i nevojave të trajnimit bazuar në kërkesat e tregut. ✓ Përmirësimi i bashkëpunimit publiko-privat midis shkollave të trajnimit dhe ndërmarrjeve. ✓ Përditësimi i kurrikulave në bazë të kërkesave të tregut. ✓ Testimi i strukturave inovative të pagave, studimi dhe analizimi i këtyre masave dhe ndikimin e tyre që tregon produktivitetin aktual dhe atë të dëshiruar, matjen e performancës, kosto/përfitimin dhe statistikën e cilësisë. ✓ Ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve të brendshme dhe të jashtme për personelin e menaxhmentit. ✓ Zbatimi i skemave atraktive të pagesës për personelin kyç menaxhues në ndërmarrjet e fokusuar në eksport.
Qasja në treg dhe pengesat në procesin e eksportit	▪ Të dhënat e pamjaftueshme dhe jo të besueshme të tregut. Të dhënat e tregut dhe segmentet e klientëve nuk janë të njohura mjaftueshëm në vende të ndryshme të synuara të BE-së, duke rezultuar në strategji të paqarta të marketingut, produkteve dhe të komunikimit me klientë. ▪ Segmentimi dhe pozicionimi reaktiv në tregje, duke i	✓ Zhvillimi i trajnimeve dhe mbështetja e ndërmarrjeve eksportuese për të ngritur kapacitetet e tyre në lidhje me hulumtimin e tregut dhe për ta transferuar atë në strategjitë e marketingut dhe përmirësimi i përparësive konkurruese të segmentuara. ✓ Rreshtimi i kërkesave të tregut me kurrikulat e ofruara, si dhe forcimi i kapacitetit të ofruesve ekzistues të shërbimeve. ✓ Zhvillimin e bisedimeve të rregullta të sektorëve me përfaqësuesit e të gjithë

	shfrytëzuar lidhjet aktuale ose njoftësitë. ▪ Shumica e ndërmarrjeve kosovare të tekstilit nuk e kanë personelin e duhur të specializuar për përgatitjen apo mirëmbajtjen brenda ndërmarrjes të shërbimeve të ueb-it dhe marketingut të mediave të reja. Gjithashtu, nuk shfrytëzojnë mjaftueshëm kanalet e reja të komunikimit dhe shitjes. ▪ Për shkak të analizës dhe hulumtimit të dobët të tregut, potencialet e tij mbeten të pa shfrytëzuara.	akterëve të përfshirë në ZV, me qëllim përmirësimin e lidhjeve, ristrukturimin e kostove dhe ekonomizimin e zinxhirit të furnizimit / logjistikës dhe çështje tjera që mund të përmirësojnë gjendjen aktuale. ✓ Përfshirja e kurseve të reja të trajnimit të medias dhe komunikimit në strukturën e AAP-së për aplikim industrial. ✓ Fuqizimi i prezencës në media sociale për qëllime marketingu, dhe zhvillimi i komunikimit. ✓ Zbatimi i një strategjie sistematike të marketingut të eksportit, duke filluar me segmentimin e tregut, pasuar nga targetimi / diferencimi i tregut dhe pozicionimi në treg, të ndjekura nga një marketing miks të përshtatur enkas për secilin segment të klientëve ose treg të përcaktuar.
Operacionet biznesore	▪ Alokimi i dobët i investimeve - Investimet në Hulumtim dhe Zhvillim të produkteve janë të pamjaftueshme, sidomos kur synohet zgjerimi i eksportit në tregje të reja. Gjithashtu investime të ulëta në strategji të mirëfillta të marketingut, komunikimit dhe shitjes. ▪ Kapacitete të vogla të ndërmarrjeve për të përmbushur porosi më të mëdha të eksportit. Për shkak të madhësisë së vogël të numrit më të madh të ndërmarrjeve kosovare, madhësia e porosive të eksportit është e kufizuar. ▪ Mungesa e planifikimit strategjik të biznesit - numri më i madh i ndërmarrjeve operojnë pa plan biznesi, përfshirë planin e marketingut dhe të eksportit. Ndërmarrjet nuk kanë vizion dhe objektiva të qarta si dhe shpesh veprojnë në baza reaktive. ▪ Menaxhimi i inovacionit dhe prioritizimi i masave të inovacionit nuk janë zhvilluar mjaftueshëm në të gjithë sektorët. Ndërmarrjet shpesh nuk bëjnë dallime midis potencialeve të ndryshme të	✓ Ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve në ndërmarrje për planifikimin e investimeve dhe strategjitë e investimeve, të cilat integrohen në planifikimin e biznesit. ✓ Ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve të brendshme dhe të jashtme ose konsulencave që përfshijnë eksportin, marketingun bazik miks dhe buxhetimin e marketingut. ✓ Ofrimi i trajnimeve për ndërmarrjet në zhvillimin e dokumenteve strategjike, hartimin e planeve të biznesit duke shfrytëzuar teknikat moderne. ✓ Ngritja e kapaciteteve të shoqatave për të ofruar shërbime që ndihmojnë që ndërmarrjet të integrohen dhe të jenë të afta për të plotësuar porositë më të mëdha të eksportit, duke hapur kështu mundësi me segmente alternative të klientëve. ✓ Krijimi i bashkëpunimit më të madh dhe më të mirë midis ndërmarrjeve dhe nënkontraktuesëve përmes takimeve të rregullta ndërmjet operatorëve të Zingjirit të Vlerës së këtyre sektorëve. (krijimi i klasterëve) ✓ Inicimi i praktikave inovative në sektorët e tekstilit, veshjeve dhe lëkurës, përmes organizimit të tryezave që do shtynin këtë agjendë. Vlerësimi i gjendjes aktuale, analizimi i trendëve dhe orientimi i sektorëve dhe se si ndërmarrjet vendore duhet të qasen dhe përfitojnë.

	inovacionit të produktit dhe procesit.	
Mungesa e furnizimit me lëndë të parë:	▪ I gjithë procesi i prodhimit të ndërmarrjeve të këtyre sektorëve është i varur nga importi i lëndës së parë dhe materialeve të nevojshme për prodhim. Si rrjedhojë, jo rrallë herë ka vonesa, dhe ky fakt pezullon aktivitetin e prodhimit të ndërmarrjes në tërësi në mungesë të lëndës së parë dhe materialeve të nevojshme për prodhim. ▪ Në shumë raste ndërmarrjet lokale e shohin njëra tjetrën si konkurrencën kryesore e jo si partner potencial për përmirësim të mundësive për eksport.	✓ Bashkëpunimi më i ngushtë i tyre, ndërmarrjet do të jenë në gjendje të vendosin porosi më të mëdha, dhe njëkohësisht të marrin oferta me çmime më të favorshme. Promovimi i lidhjeve ndihmon në integrimin më të mirë të ZV-së së lëndës së parë.
Shërbimet mbështetëse të Zingjirit të Vlerës	▪ Mungesa e financimit për zhvillimin e eksporteve, krijimin e lidhjeve (përmes panaireve), promovimin e imazhit, dhe inovacionin. ▪ Qasje e limituar në financa. ▪ Mungesa e trajnimeve falas nga qendra adekuate, të orientuara nga kërkesat e tregut dhe jo nga projekte të paracaktuara ose aty për aty. ▪ Përkrahja e limituar nga përfaqësuesit relevant insitucional për eksport. ▪ Neglizhim i prodhueseve të vegjël, pasi që fokusi qëndron tek ndërmarrjet e mëdha.	✓ Zhvillimit të koncepteve të përbashkëta të sektorëve privat dhe ofruesëve të shërbimeve që mund të përmirësojnë qasjen në financa. ✓ Zhvillimi i fushatave të ndërgjegjësimit për sukseset e arritura nga gratë në këtë sektor, si dhe vetëdijësimi për përkrahjen e tyre në biznes. ✓ Ofrimi i përkrahjes institucionale për shoqatat e këtyre sektorëve që do kontribuonte në përmirësimin e modelit të anëtarësimit, rritjen e shërbimeve biznesore për anëtarët etj. ✓ Fuqizimi i shoqatave të sektorëve të tekstilit, veshjes dhe lëkurës për të ngritur kapacitetet e saj në përkrahjen e ndërmarrjeve për eksport.
Mungesa e zonave industriale në të disa komuna të Kosovës.	▪ Një ndër sfidat e identifikuar nga ky studim është dhe mungesa e zonave industriale në disa Komuna të Republikës së Kosovës me qëllim të krijimit të infrastrukturës fizike të përshtatshme. ▪ Duke pas parasysh benefitet që sjell zona industriale, përfshirë ofrimin e hapësirës së nevojshme për prodhim, vlerë e qirasë me të përballueshme, dhe sigurimi i energjisë elektrike sepse për shumë ndërmarrje	✓ Ndërtimi i zonave industriale në të gjitha Komunat Republikës së Kosovës do të mundëson kushte më të favorshme për të zhvilluar aktivitetet biznesore, jo vetëm për këta sektorë. ✓ Identifikimi i Komunave me potencial më të madh në këtë sektor dhe jo vetëm, për ndërtimin e këtyre zonave. ✓ Zhvillimi i bashkëpunimit më të ngushtë me institucionet relevante lokale dhe qendrore për realizimin dhe ofrimin e mjedisit biznesor. ✓ Përfshirja e ndërmarrjeve të vogla në aktivitetet e sektorëve, si dhe fuqizimi i tyre

	mungesa e saj konsiderohet si kufizim i cili ndikon në procesin total të prodhimit.	përmes shkëmbimit të përvojave, ideve dhe pengesave të ndryshme. ✓ Në këto zona industriale të themelohen qendra të trajnimit dhe ofrimit të shërbimeve të nevojshme për ndërmarrjet të cilat shfrytëzojnë këto hapsira.
Pandemia Covid-19.	▪ Situata pandemike gjithashtu konsiderohet si kufizim i ndërmarrjeve të këtyre sektorëve. - Si pasojë e situatës së përkeqësuar me pandeminë Covid-19 viti paraprak ishte më pak fitimprurës në përgjithësi. ▪ Përveç më pak fitim prurës, kjo situatë ka shkaktuar panikë dhe ka ndikuar në efikasitetin e punëtorëve.	✓ Ofrimi i mbështetjes institucionale për ndërmarrjet e këtyre sektorëve. ✓ Adaptimi i strategjive biznesore, dhe të bërit biznes krahas trendeve aktuale të ndikuara nga pandemia Covid-19. ✓ Ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve dhe konsulencës për format e shitjes online. ✓ Ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve dhe konsulecës për format e komunikimit online.

REFERENCAT

- United Nations Industrial Development Organization, (2020). Industrial Development Report – ([UNIDO IDR2020-English overview.pdf](#))
- Women in Informal Employment: Globalizing and Organizing, (2020). Annual Report April 2019 – March 2020. ([WIEGO AnnualReport 2019 2020 Interactive.pdf](#))
- Castaneda-Navarrete J, Hauge J, Lopez-Gomez C. (2020), Covid-19's impact on global value chains, as seen in the apparel industry. ([Covid-19 impact on global value chains as seen in the apparel industry.pdf](#)).
- EFC, COTAGE, EURATEX, INDUSTRY ALL-EUROPEAN TRADE UNION, Joint statement, Brussels, May 2021.
- Mbretëria e Bashkuar, Dhoma e përbashkët, Komiteti i Auditimit Mjedisor, 2019.
- FEM (Fundacioni Ellen Macarthur). Një ekonomi e re e tekstileve: Ridizajnimi i së Ardhmes së Modës, 2017 – (<https://ellenmacarthurfoundation.org/a-new-textiles-economy>)
- Sharpe, Samantha A. 2017. Environmental Scoping Study: Decent Work in the Garment Sector Supply Chains in Asia
(https://labordoc.ilo.org/discovery/fulldisplay?vid=41ILO_INST:41ILO_V1&search_scope=MyInst_and_CI&tab=Everything&docid=alma995109493102676&lang=en&context=L&adaptor=Local%20Search%20Engine&query=sub,exact,work%20organization&offset=10)
- International Labour Organization (ILO) – (Maj 2021) – Reducing the footprint? Hot to access carbon emissions in the garment sector in Asia.
(https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/asiarobangkok/documents/publication/wcms_781938.pdf).
- International Trade Centre – Impact of Covid19 on the Global Market and Local Industry of Textile and Clothing – (December 2020) - [ImpactofCovidonTCindustry Egypt eng.pdf](#)
- International Monetary Fund – (2021) - World Economic Outlook Update - [IMF Updated version 2021.pdf](#)
- Hauge J. – Industrial policy in era of global value chains: Towards a developmental framework drawing on the industrialization experiences of South Korea and Taiwan - [Hague 2020.pdf](#)
- The World Bank Development Research Group Trade and Integration Team – The Global Apparel Value Chain, Trade and the Crisis – Challenges and Opportunities for Developing Countries – April 2010 - [The Global Apparel Value Chain, Trade and the Crisis 2010.pdf](#)
- Sektori i Industrisë së përpunimit të Tekstilit, Veshjes dhe Lëkurës, Kiesa, 2019 - <https://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=1,103>